



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 18 MARS 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
18. MARTA 2010. GODINE

MARS – MARTA
2010

Seancën e kryesoi Jaku KRASNIQI, Kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Ibrahim GASHI, an tar i Kryesisë së Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatohet në sallë janë 63 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Me këtë rast e përshëndes dhe i uroj punë të mbarë deputetit të ri nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, zotit Abdyl Ymeri.

Të nderuar deputetë,
Seanca e sotme është caktuar në pajtim me vendimin e seancës plenare të mbajtur më 11 mars 2010, me të vetmen pikë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë së energjisë për periudhën 2009 – 2018

Para se të fillojmë debatin, mendoj që është mirë t'i kenë shifat e grupeve parlamentare nga 10 minuta për diskutim, deputetët nga 5 minuta.

(Reagime nga salla)

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:
Regjia, përgatitu. Propozimi është: shifat e grupeve parlamentare dhe 10 minuta, deputetët nga 5 minuta. Mendoj që është kohë e mjaftueshme për t'i thënë, nëse jeni të përgatitur për të thënë diçka.

Në sallë kemi 70 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:
Konstatohet se me 41 votë “për”, 15 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet vendimi ose kërkesa që diskutimet për shifat e grupeve të jetë 10 minuta, për deputetë 5 minuta. Ju falënderoj. Salla vendosi dhe unë e respektoj shumicën.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar dhe Kuvendit ia ka parashtruar për miratim Propozim – strategjinë e energjisë për periudhën 2009 – 2018.

Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat të Rregullores së Punës e ka shqyrtuar Propozim – strategjinë e energjisë për periudhën 2009 – 2018 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Propozim – strategjia e energjisë për periudhën 2009 – 2018 dhe raporti me rekomandime u është shpërndarë deputetëve.

Radha është që përfaqësuesi i Qeverisë, ministria për Energji, të prezantojë Projekt – strategjinë.

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA PULA: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Ministria e Energjisë dhe e Minierave, në bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, KOSTT-in, KEK-un, Ngrohtoret e qytetit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në përputhje me kërkesat e Ligjit për energji elektrike 2004/8, gjatë vitit 2009 rishikoi Strategjinë e energjisë 2005 – 2015, dhe bazuar në atë, përgatiti Strategjinë e energjisë për periudhën 2009 – 2018.

Qeveria e ka miratuar këtë strategji, të cilën komisioni funksional i Kuvendit ua ka paraqitur për miratim, sot.

Kjo strategji bazohet në Programin e Qeverisë për Sektorin e Energjisë, si dhe në platformën e politikës energjetike të Kosovës, të përgatitur së bashku me Bankën Botërore dhe Departamentin e shtetit të Amerikës, e dokumentuar kjo në letrën e datës 6 korrik 2009. Kjo platformë ka marrë edhe përkrahjen e Komisioni Evropian dhe Zyrës Civile Ndërkombëtare.

Strategjia që ju propozoj ta miratoni sot, bazohet në një analizë të plotë që ne e kemi kryer për situatën e sektorit energjetik dhe të nevojave për energji për periudhën dhjetëvjeçare 2009 – 2018.

Bazuar në këtë analizë, duke njohur nevojën për pjesëmarrje në sektorin privat, duke pasur parasysh obligimet që Kosova i ka në kuadër të Traktatit për komunitetin e energjisë, ne kemi identifikuar sfidat me të cilat përballemi, kemi vendosur objektiva strategjike që duhet të arrijmë dhe kemi propozuar politikat, masat dhe programet apo projektet kryesore që duhet t'i zbatojmë në mënyrë që t'i arrijmë objektivat.

Strategjia e energjisë 2009 – 2018, u kushton vëmendje të veçantë përputhshmërisë me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropianë, që për sektorin e energjisë janë të obligueshme për Kosovën në kuadër të anëtarësisë në Traktatin e komunitetit të energjisë.

Strategjia synon: stimulimin e përdorimit racional të energjisë dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të saj, shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, futjen e teknologjive të reja dhe zbatimin e standardeve mjedisore siç ato parashikohen me ligj.

Strategjia është e ndarë në dy pjesë: Pjesa e parë, përmban një paraqitje komplete dhe analizë të situatës aktuale dhe të progresit të arritur në sektorin energjetik gjatë periudhës 2006 – 2008, përfshirë politikat e zbatuara deri më tani, kuadrin ekzistues ligjor dhe rregullator, institucionet dhe ndërmarrjet ekzistuese energjetike, analizën e konsumit, të prodhimit, bartjen dhe shpërndarjen e furnizimit të energjisë, progresin në sektorin e ngrohjes, gazit natyror, efikasitetit të energjisë dhe të burimeve të ripërtëritshme, mbështetjen financiare publike dhe nga donatorët për sektorin energjetik, si dhe progresin e arritur në fushën e integritetit rajonale dhe evropiane.

Nga analizat e paraqitura në pjesën e parë të strategjisë, janë identifikuar sfidat përpara sektorit energjetik, sfida këto ku mbështeten objektivat strategjike të shënuara në pjesën e dytë të dokumentit.

Pjesa e dytë përmban: parashikimin e nevojave për energji për periudhën 2009 – 2018, në total dhe për secilin sektor ekonomik, misionin dhe vizionin e strategjisë, objektivat strategjike, politikat dhe masat prioritare për realizimin e objektivave strategjike, perspektivën e integritimeve evropiane dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, nevojën dhe masat për ngritjen e kapaciteteve institucionale vendore dhe masat e parashikuara për zbatimin e kësaj strategjie.

Fokus të veçantë në këtë strategji ka rritja sa më parë të jetë e mundur e sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm cilësor me energji elektrike. Për këtë, rëndësi e veçantë i është kushtuar ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike dhe rehabilitimit në kohën e duhur të Termocentralit “Kosova B”, të dyja këto me pjesëmarrjen e sektorit privat.

Përmirësimi i nivelit të faturimit dhe të inkasimit të energjisë elektrike të shpenzuar përbën një sfidë të rëndësishme për KEK-un dhe institucionet e vendit. Ne mendojmë se arritja e objektivave të vendosura për rritjen e inkasimit do të përbëjë një bazë mjaft të mirë për të rritur besimin e investitorëve në sektorin energjetik, si dhe do të ulë masën e rrezikut të perceptuar prej tyre.

Zbatimi i qasjes evropiane sa i takon energjisë, mjedisit dhe konkurrencës, është në vëmendje të kësaj strategjie. Kjo do të mundësojë integrimin e sektorit energjetik të vendit tonë në sistemet energjetike evropiane. Vëmendja e veçantë i kushtohet mbrojtjes së mjedisit nga emetimet ndotëse të stabilimenteve energjetike. Edhe rritja e eficiencës së energjisë dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtitshme të energjisë konsiderohet elemente të rëndësishme të kësaj strategjie.

Politika dhe masa të qarta janë përfshirë në këtë dokument për këta dy sektorë të rëndësishëm.

Strategjia synon përgatitjen e një kuadri të plotë ligjor dhe rregullator që do të mundësojë tërheqjen e investimeve të konsiderueshme private në sektorin energjetik.

Korniza rregullatore e Sektorit të energjisë të Kosovës synohet të jetë e plotë dhe e qartë në mënyrë që të arrihet besimi i investitorëve të huaj në të.

Ndërkohë, duhet t’ju rikujtoj se kjo strategji është miratuar nga Qeveria në muajin shtator 2009. Pra, mjaft muaj kanë kaluar dhe kuptueshëm ka pasur edhe zhvillime, të cilat besoj se ju dëshironi t’i diskutoni dhe të merrni edhe vendime. Ajo që unë dua të bëj të qartë, është se të gjitha vendimet dhe hapat e Qeverisë sidomos lidhur me tërheqjen e investimeve private në sektorin energjetik, nuk janë në kundërshtim me këtë strategji. Në parim, strategji nuk përfshinë të gjitha detajet për secilin projekt, përfshirë edhe atë të projektit të Termocentralit “Kosova e Re”.

Të nderuar deputetë,

Nga rekomandimi që komisioni funksional i Kuvendit ju ka dërguar gjithsecilit prej jush, duket që janë paraqitur disa propozime për vendimmarrje prej Kuvendi, rekomandime që lidhen me Projektin “Kosova e Re”.

Unë dëshiroj t'ju ftoj që në diskutimet tuaja të mbani parasysh se qëllimi ynë si Qeveri është që të mos i largojmë, por t'i afrojmë investitorët potencial, kjo gjithnjë duke pasur parasysh, së pari, ruajtjen e interesit të popullit të Kosovës.

Tani, po përmbledh shkurtazi disa sqarime, si dhe një informacion të ditëve të fundit nga këshilltarët e transaksionit të projektit - Termocentrali "Kosova e Re" lidhur me rekomandimet e komisionit funksional parlamentar.

1) A do të përfshihet apo jo Termocentrali "Kosova B" në paketën e Termocentralit të Ri. Në Strategjinë e energjisë 2009 – 2018, parashihet rivitalizimi i Termocentralit "Kosova B" me investime private kur këtij termocentrali t'i vjen koha. Kuptohet, pasi që të futen në operim blloku i parë i Termocentralit "Kosova e Re", pra aty rreth vitit 2016. Kjo bazohet në atë që kryeministri, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe të Departamentit të Shtetit të Amerikës dhe përkrahjen e Komisionit Evropian e të partnerëve tjerë ndërkombëtarë e paraqiti si politikë më të re energjetike, më 15 korrik 2009.

B) Ne, si komitet dhe drejtues i projektit...

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni fjalën ministres!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA PULA: ... ne, si komitet dhe drejtues i projektit dhe bashkë me ne edhe Qeveria, jemi dakorduar me kërkesën e këshilltarëve të transaksionit që të konsiderojmë opsionin e futjes së Termocentralit "B" në Termocentralin "Kosova e Re" për të parë se më leverdi mund të jetë ky opsion. Ndërkohë, u kemi kërkuar këshilltarëve që të na sigurojnë që ky opsion nuk është në kundërshtim me direktivën evropiane, gjë për të cilën nuk kemi marrë përgjigje ende.

Ajo që këshilltarët e transaksionit të Projektit Termocentrali "Kosova e Re" sa po e kanë paraqitur, është që kjo pjesëmarrje mund të jetë 25, 35, nëse në paketën e "Kosovës së Re" Qeveria do të futë Termocentralin "Kosova B" dhe asetet dhe pajisjet e Minierës së KEK-ut në Korporatën e linjitit. Kjo pjesëmarrje mund të jetë më e madhe nëse i rrisim tarifën e energjisë elektrike.

Ne në Komitetin drejtues të projektit kemi pritur pjesëmarrje shumë më të madhe dhe nëse kjo nuk do të jetë e mundur, do t'i drejtohem Qeverisë për të marrë vendime të duhura lidhur me këtë opsion. Ju si ligjvënës mund të merrni vendim që ju mendoni se është i duhur për këtë çështje.

Pyetja e dytë – Kapacitetet e Termocentralit "Kosova e Re". Për sqarim tuaj, parashikimet janë që deri në vitin 2025, Kosovës do t'i duheshin rreth 2000 megavat të instaluar. Prandaj, edhe në strategji kemi parashikuar që të ndërtojmë 2000 megavat në periudhën afatgjatë dhe mundësinë për të shfrytëzuar të gjithë Sibovcin, por deri në vitin 2018, periudhën që mbulohet nga kjo strategji, na duhen aty rreth 1000 megavat.

Këshilltarët e transaksionit të Termocentralit "Kosova e Re" vlerësojnë se investitorët janë të interesuar të ndërtojnë fillimisht 500 megavat, me mundësi edhe për 500 megavat të tjerë, kur kjo të bëhet nga tregu kryesisht vendor. Ky propozim rrjedh, sepse investitorët e kanë vështirë të sigurojnë financime me kushte aktuale të tregjeve financiare. Të paktën kështu na thonë këshilltarët, të cilët kanë trashëguar....

(Reagim nga salla)

Jo, jo, nuk është s'ka mendim, ne i thamë çka kemi, ju lutem, ... të cilët kanë trashëguar të drejtën nga Qeveria e kaluar, të kontaktojnë direkt dhe vetëm me investitorë, pra, pa përfaqësues të Komitetit drejtues të projektit, gjë të cilën tani unë dhe Komiteti drejtues e kemi ndaluar të ndodhë në të ardhmen. Edhe për këtë çështje, ju si ligjdhënës, keni të drejtë t'i thoni fjalët e fundit.

Na falni deputetë,

Nëse keni dëgjuar mirë, unë nën a) e thashë atë çka e kemi paraparë në strategji. Në strategji e kemi paraparë që deri në vitin 2018 të ndërtojmë 1000 megavat, unë e thashë se çka kemi nga këshilltarët e transaksionit, e juaja është të vendosni, ne e kemi paraparë në strategji. Prandaj, strategjia jonë është diçka tjetër, unë paralelisht jam duke ju dhënë edhe mendimin e këshilltarëve të transaksionit. Prandaj, ju s'mund të thoni që ne s'kemi mendim. Ne kemi mendim, po i kemi edhe këto propozime. Edhe ju, në fakt, jeni ligjvënës dhe keni të drejtë të thoni fjalën e juaj, ju lutem!

3) Lokacioni për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re”. Komisioni i Kuvendit rekomandon që lokacioni të jetë ai pranë Termocentralit “A”. Në Strategjinë e energjisë 2009 – 2018 nuk definohen lokacioni, sepse mendojmë se kjo është një çështje me shumë teknike, ekonomike dhe për negociata për investitorë.

Preferohet që “Kosova e Re” të ndërtohet në lokacionin pranë “Kosovës B” sepse sipas analizave të kryera në kohën e fundit, ky lokacion ofron zgjidhje më të lirë, më të shpejtë dhe më të realizueshme. Edhe për këtë çështje, ju si ligjvënës, e keni të drejtën të thoni fjalën e juaj.

Me këtë rast duhet t'i përmendi edhe dy çështje shumë të rëndësishme.

Çështja e parë: Në strategji nuk e kemi shënuar se do të kryejmë Korporatën e re të linjitit dhe ne kemi lënë të hapur çështjen se a mund të jepet tërë Sibovci apo një pjesë e tij. Për shembull, në pakon e “Kosovës së Re” kështu u dakordua më 15 korrik, sipas performancës së letrës së 6 korrikut 2009. Por, tani kemi shumë informacione dhe ne në Komitetin drejtues të projektit kemi marrë qëndrim që të jepet leja për shfrytëzimin të linjitit vetëm për një pjesë të Sibovcit, që është e mjaftueshme për të furnizuar Termocentralin “A”, Termocentralin “B”, Termocentralin “Kosova e Re” me 500 megavat dhe mundësi të zgjerimit deri në 500 megavat të tjerë.

Çështja e dytë: Meqë kanë kaluar mbi 6 muaj prej miratimit në Qeveri të strategjisë në shtator të vitit 2009, janë përpunuar tashmë edhe disa të dhëna për tërë vitin 2009. Edhe pse nuk ndikojnë në përbërjen e strategjisë, ne mendojmë t'i azhurnojmë.

Në përfundim, dëshiroj të falënderoj komisionin parlamentar funksional që ju ka rekomanduar të miratoni në parim Strategjinë e energjisë 2009 – 2018.

Ndërkohë, ju lutem, të nderuar deputetë, të miratoni Strategjinë e energjisë 2009 – 2018, si dhe të na mbështesni më tej në zbatimin e saj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre!

Fjala tani është për kryetaren e komisionit funksional, deputeten Myzejene Salmani, në emër të Komisionit.

MYZEJENE SELMANI: Po, faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për dy zëvendëskryeministrat që janë këtu, për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë parasysh prezantimin që e bëri ministria, njëkohësisht ajo edhe i dha edhe rekomandimet e Komisionit, unë do të shkoj shumë shkurtimisht. Komisioni parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport, Telekomunikacion, me datën 19.01. 2010 dhe më 25.01.2010 e shqyrtoi Strategjinë e energjisë për periudhën 2009 – 2018, dhe i rekomandoi Kuvendit të Republikës së Kosovës se Komisioni parlamentar e mbështet, në parim, Strategjinë e energjisë, të rinovuar, për periudhën 2009 – 2018, duke kërkuar që Termocentrali “Kosova B” të mos përfshihet në pakon e tenderimit të privatizimit të Termocentralit “Kosova e Re” edhe pse në strategji nuk është, është e vërtetë atë që e tha ministria.

b) Termocentrali “Kosova e Re” mundësisht të ndërtohet në lokacionin e Termocentralit “Kosova A”, dhe,

c) Ndërtimi i kapacitetit gjenerues të Termocentralit “Kosova e Re” të bëhet në bazë të bilancit energjetik që ka Kosova që, sipas tij, për fazën e parë parashihen nevojat e kapaciteteve prej 1000 megavatësh.

Arsyetimet janë dhënë, ky është rekomandimi i komisionit parlamentar. Ju faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryetarët e komisioneve tjera nuk e donë fjalën. Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Kush e do fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike? Deputetja Sala Berisha - Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA - SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Dy zëvendëskryeministrat,

Përshëndetje të veçantë zonjës ministre, Shiroka Pula,

Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Në shqyrtim kemi Strategjinë e energjisë të Republikës së Kosovës. Këtë dokument Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar me vëmendje dhe ka përcjellë rrjedhat në segmente të caktuara që parashihen në këtë strategji dhe e mbështet, në parim.

Strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2009 – 2018. Dokumenti në fjalë ka ardhur në Kuvend në shtator të vitit 2009, ndërsa ne po e shqyrtojmë tani në mars të vitit 2010. Prandaj, me të drejtë dikush do të thotë se ka pasur edhe rrjedha edhe ndryshime, mirëpo ajo çka dëshiroj të them në këtë rast, është se kisha një kërkesë nga të gjithë, edhe si individë, edhe si grupe parlamentare, edhe si institucione, që të punojmë bashkërisht, t’i harmonizojmë qëndrimet, t’i harmonizojmë edhe hapat, edhe veprimet, në mënyrë që të mos kemi raste të tilla post festum. Këtë po e përmend, sepse dokumentet bazike ende janë në diskutim dhe lind pyetja me të drejtë – kush nuk po e kryen punën e vet, kush po e pengon, ku është çelësi i zhbllokimit të kësaj situate. Unë mendoj se në këtë rast për debatin që e kemi tani sot, një faj e kanë edhe komisionet parlamentare. Do të dëshiroja ta zhvendosim këtë përgjegjësi si institucione, edhe pozita, edhe opozita. A i

kemi kryer ne si komision parlamentar obligimet tona dhe ku është përgjegjësia jonë si deputetë?

Sa për ilustrim, do të ndalem në zvarritjen, për të mos thënë në hapat e breshkës që shkojnë komisionet me punët e veta e që lidhet me debatin e sotëm. Respektivisht, Projektligji për miniera dhe minerale ka kaluar në leximin e parë në korrik të vitit 2009 dhe ende është në procedurë. Projektligjet e energjisë që kanë ardhur në pako, dy prej tyre kanë kaluar leximin e parë në janar dhe ne jemi sot në mars, e dihet se me Rregulloren e Punës së Kuvendit afati kohor për t'i shqyrtuar dokumentet në fjalë është maksimumi 2 muaj ditë. Prandaj, do të doja mirëkuptim dhe mendoj se përkushtimi për të ardhmen për një Kosovë ekonomisht të zhvilluar mos të jetë vetëm deklarativ. Duhet të përcillet me punë konkrete, secili në vendin e vet, me përgjegjësinë e vet, me obligimin e vet, edhe si individë, në këtë rast si deputet, edhe si institucion. Përderisa individi është si pjesë integrale e institucionit, pa ngjyrimë partiake, në raste të këtilla mendoj se partia e të gjithëve të jetë tani për tani – zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i Kosovës. Në këtë rast, të hapet mundësia për një zhvillim ekonomik.

Si bëhet kjo mundësi? Duke qenë secili në nivelin e përgjegjësisë për kryerjen e obligimeve tona. Në të kundërtën, mendoj se me këtë shpejtësi të rrufeshme të rrjedhave ekonomike dhe jo vetëm ekonomike brenda edhe jashtë Kosovës, në këtë vorbull të globalizimit të ekonomisë së tregut do të kemi fatin e gjarprit me dy krerë, me kahe të kundërt i ndodhur në mes të rrebeshit të një zjarri të rrufeshëm.

Të nderuar deputetë,

Për ta mos përsëritur ministren, secili e kemi dokumentin përpara dhe e kemi analizua edhe si deputetë, edhe si grupe, edhe në komisione parlamentare.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Strategjia e energjisë paraqet një shteg të mundësisë për Kosovës për t'ju adresuar një diapazoni të gjerë të qëllimeve ekonomike dhe sociale.

Strategjia e energjisë siguron kornizën përmes së cilës Kosova mund ta shfrytëzojë këtë mundësi për të mirën e të gjithë qytetarëve të saj. Zhvillimi i sektorit të energjisë kërkon koordinim me pjesëmarrje aktive nga gjithë faktorët vendimmarrës. Bazë për hartimin e strategjisë kanë qenë edhe tri ligje të sektorit të energjisë, si dhe rekomandimet dhe direktivat relevante të hartuara nga ana e institucioneve të BE-së.

Në hartimin e këtij dokumenti Ministria ka pasur parasysh ruajtjen e interesave të qytetarëve të Kosovës, duke u mbështetur në tri parime kryesore: zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, përmirësimin e mirëqenies sociale dhe respektimin dhe mbrojtjen e vlerave mjedisore në pajtim me dokumentet relevante ndërkombëtare, të cilat jemi të obliguar t'i respektojmë.

Traktati mbi krijimin e komunitetit të energjisë, si vazhdimësi e procesit të Athinës, i nënshkruar nga ana e shteteve të Evropës Juglindore, duke përfshirë edhe Kosovën, me të cilin përcaktohen parimet e funksionimit të tregut të lirë dhe pa diskriminim të energjisë, është një shans për Kosovën, por edhe obligim që ajo të përgatite sa më shpejt për të qenë e aftë për biznes të suksesshëm në këtë treg.

Ndërrimet dhe parimet në sferën e legjislacionet për energji kanë ndikuar në tërë rajonin, e me këtë edhe në Kosovë, për çka edhe ne kemi në shqyrtim plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve të pakos së energjisë. Do me thënë, me këtë edhe në Kosovë, e cila është pjesëmarrëse e barabartë në shumë procese rajonale ndërkombëtare për energji dhe është nënshkruese e Memorandumit të Athinës për energji, i cili parasheh shumë zhvillime në energji dhe njëkohësisht kërkon ristrukturimin e sistemeve energjetike në vendet e rajonit të cilat janë nënshkruese të këtij traktati. Edhe pse me vështirësi, Kosova nuk ka ngecur në zhvillimet e sektorit energjetikë. Në bashkëpunim rajonal kontribut i veçantë është edhe bashkëpunimi rajonal, që në këtë dokument të strategjisë rol të rëndësishëm ka edhe bashkëpunimi me Shqipërinë dhe marrëveshja e nënshkruar për këmbimin e energjisë, përderisa e dimë se Shqipëria kryesisht furnizohet me hidropotenciale, ndërsa ne në Kosovë me termopotenciale.

Këto janë rrugë të transformimeve nëpër të cilat domosdo duhet të kalojmë që të mos e humbim asnjë hap drejt zhvillimit të gjithëmbarshtëm të vendit tonë.

Sigurisht, zhvillimi i energjetikës së Kosovës nuk mund të jetë vetëm autokton, vendor, përkundrazi krijimi i shtetit kërkon një sistem energjetik optimal funksional, i pranueshëm në raport miqësor me mjedisin dhe i integruar në rajon dhe në Evropë, i hapur dhe konkret për tregun.

Ministria e Energjisë dhe e Minierave në dokumentin e saj për strategjinë e zhvillimit të sektorit të energjisë në Kosovë, pos tjerave i paraqet dhe i parasheh ndërrimet ligjore, organizative, institucionale, pronësore dhe ekonomike dhe të tjera në këtë fushë shumë të rëndësishme.

Te planifikimi i strategjisë është marrë parasysh ruajtja e interesave kombëtare, zhvillimi i tregut të energjisë në Evropë. Kosova duhet të zhvillojë tregun e brendshëm në përputhje me kërkesat nga reformat në sektorin e energjisë për gjithë Evropën.

Të nderuar deputetë,

Për të mos e analizuar veç e veç pjesën e parë dhe pjesën e dytë të kësaj strategjie, për të cilën edhe foli ministria dhe për të mos u përsëritur, një vëmendje të posaçme dëshiroj ta hedh në faqen 33, ku kemi parashikimin e kërkesës për energji. Shihet se kërkesa për energji çdo vit është në rritje për çdo sektorë. Prandaj, është e paraqitur shumë detajisht.

Parashikimi i prodhimit të energjisë për vitin 2009 – 2018 është një paraqitje reale. Duke analizuar tabelat, shohim se Kosova ka nevojë për import deri më 2015.

Përgjithësisht shikuar sipas këtij dokumenti, energjia elektrike në Kosovë bazohet në prodhimin e energjisë nga Termocentrali “Kosova A” dhe Termocentrali “Kosova B”, Hidrocentrali i Ujmanit, hidrocentralet ekzistuese dhe të reja, ai i Zhurit dhe nga termocentrali “Kosova e Re”.

Si një nga objektivat strategjike është edhe kjo se Kosova synon integrimin sa më parë në BE. Kjo gjë do të kërkojë edhe zbatimin e objektivave 20,20,20 të planit të BE-së, që do me thanë 20% reduktimi i emetimit të gazrave që krijon efektin serë, 20% rritje në pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme në konsumin e energjisë dhe 20% në përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Jemi dëshmitarë se Qeveria veç ka filluar t’i zbatojë këto objektiva.

Rëndësi në strategjinë e energjisë iu është kushtuar edhe masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale. Qeveria është e zotuar për ngritjen e çështjeve sociale, që rezultojnë nga zhvillimi i minierave në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Një vend të rëndësishëm zë edhe Projekti “Kosova e Re”, është pjesë shumë e rëndësishme e kësaj strategjie. Ky projekt parashihet të ndërtohet në faza ashtu që të harmonizohen afatet kohore kur mund të hyjë në funksion “Kosova e Re” dhe të dalë nga funksioni Termocentrali “Kosova A”. Pra, faza e parë mundëson zëvendësimin e Termocentralit “Kosova A” që të përmbushë nevojat vendore dhe gjatë kësaj kohe të bëhet rehabilitimi i Termocentralit “Kosova B”.

Faqe 27, është paraqitur, siç thamë, bashkëpunimi dy palësh, që është shumë me rëndësi.

Dhe, krejt në fund, për ta kursyer kohën, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës gjatë analizimit të këtij dokumenti shumë të rëndësishëm i rekomandojmë Qeverisë që të marrë masa për të themeluar dhe funksionalizuar sa më shpejt Korporatën e linjtit për këto arsye:

1. Të realizohet pronësia e Kosovës ndaj burimeve të linjtit, me mundësi për dhënie të një pjese të aksioneve, sipas nevojës, për investime private.
2. Korporata do të furnizojë me linjit kapacitetet ekzistuese të Termocentralit “Kosova A” dhe të Termocentralit “Kosova B” dhe blloqet e Termocentralit “Kosova e Re”. Në qoftë se problemet...

KRYETARI: Edhe një minutë, pra. Shefave e grupeve, nëse kanë nevojë ua zgjasim nga një minutë të gjithëve.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit! Problemet e trashëguara mjedisore, në qoftë se do të negociohen që t’i bartin investitorët, por duhet të mendojmë edhe alternativa tjera. Pra, Korporata e linjtit do të ketë mundësi t’i trajtojë këto probleme, duke krijuar fonde të nevojshme nga shitja e thëngjillit dhe jo nga buxheti i Kosovës. Korporata e linjtit do të ketë përgjegjësinë për t’i mbyllur përfundimisht dhe rikultivuar mihjet ekzistuese në Bar dhe Mirash. Kjo është paraparë edhe në ligjin që kemi në procedurë, në Ligjin për miniera. Sugjerimi tjetër për qeverinë është që i gjithë procesi dhe paketa për Termocentralin e Ri të jetë në përputhje me obligimet që Kosova i ka në kuadër të anëtarësisë së Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Në fund, të nderuar deputetë, kërkoj ta mbështesni këtë dokument dhe uroj që sa më parë Qeveria ta përgatisë programin për zbatimin e kësaj strategjie. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Debati lidhur me dokumentin e ofruar për Strategjinë e energjisë mendoj që duhet të shkojë në drejtimin që e meriton një dokument i tillë për rëndësinë e madhe ekonomike, jo veç në sektorin e energjisë, por për gjithë vendin.

Prandaj, edhe ajo që u tha nga ministrja apo nga kolegja më herët, mendoj që vonesa nuk i kontribuon kësaj, sepse është dokument që është dashur të aprovohet në vitin 2009, ndërsa veprimet tjera që i ka bërë Qeveria nuk përputhen me këtë dokument të cilin e kemi para vetes dhe për cilën mendoj se do të aprovohet, në parim, me rekomandime dhe ndryshime që i nxjerr Kuvendi.

Në kuadër të këtij dokumenti lexohet mirë dhe shikohet se objektivat kryesore dhe synimet strategjike në fushën e energjisë për Kosovën janë plotësisht të arsyeshme, sikur që kanë të bëjnë edhe me promovimin e resurseve dhe të potencialit energjetik që ka vendi ynë.

Njëkohësisht, në dokument kemi po ashtu edhe analizat lidhur me shkallën e zhvillimit ekonomik dhe në këtë plan përcjellja e sektorit energjetik të Kosovës që duhet, po ashtu, të jetë në hap e në harmoni me këtë plan ekonomik.

Krijimi i tregut energjetik dhe i konkurrencës është pjesë e këtij drafti, që mendoj se rol të veçantë ka sektori privat dhe është në harmoni të plotë me politikat që duhet t'i ketë një vend për sektorin energjetik.

Ngjashëm është edhe pjesa e ristrukturimit dhe e zhvillimit të këtij sektori energjetik kur kemi të bëjmë me politikat lidhur me KEK-un dhe masat të cilat duhet të ndërmerren që të kemi për aq kohë sa është në këtë pronësi, pra, edhe përmirësimin e performancës të kësaj ndërmarrje publike. Një pjesë e veçantë i është kushtuar edhe analizave dhe parashikimit të nevojave për energji elektrike në vend, që kujtoj se është edhe baza mbi të cilën do të ndërtohet nesër edhe objektivi tjetër, pra, i kapaciteteve të reja lidhur me plotësimin e këtyre kërkesave dhe nevojave të mëdha që ka vendi sot, por do të ketë edhe për dekadat e ardhshme.

Është nxjerrë, po ashtu, edhe përparësia që Kosova të hyjë, pra, me një potencial, me kapacitete të reja lidhur me bilancin rajonal edhe tregun energjetik. Ndoshta këtu ka vend për debat, për arsye se këtu kemi një disharmoni mes atij potenciali dhe përparësive krahasuese që i ka Kosova në shfrytëzimin e linjitet në raport me vendet tjera në regjion, kapacitete të cilat aktualisht ka nevojë për energji ky regjion, të cilat thuhet se janë diku rreth 20 mijë megavat fuqi, pra, të re, prej të cilave mendoj që duhet të shikohen mirë kapacitetet e reja që duhet të ndërtohen në vend, duke e ditur se përpunimi dhe kthimi në energji elektrike i linjitet të Kosovës është dukshëm shumë më i lehtë se sa i resurseve të ngjashme në vende të tjera. Prandaj, këtu duhet të shikohet strategjia lidhur me ndërtimin dhe investimet e reja në fushën e energjetikës, në mënyrë që të kemi pastaj edhe një ndikim apo impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit, sepse ne e kemi një potencial, një resurs të ngjashëm, që realisht është ndër resurset kryesore në të cilat duhet të bazohet zhvillimi ekonomik. Nuk e di sa tani kjo qëndron në harmoni me këtë strategji.

Unë i kam në ndarë dy grupe politikat dhe zhvillimet në sektorin e energjisë, të cilat mendoj se objektivat strategjike të cilat janë me vend në kuadër të kësaj, kanë të bëjnë me organizimin dhe ndërtimin e kompanisë së re të linjitet, po aty duhet të shihet më vonë, pra, sektori privat dhe pronësia që duhet t'i mbetet Kosovës, realisht duhet mendohet

mirë. Është po ashtu strategji e drejtë lidhur me planin e rivitalizimit të Termocentralit “Kosova A” dhe “Kosova B”, e cila duhet pra të shkohet dhe të vepohet në këtë drejtim pa e ndryshuar, realisht, sikur që kah ndodhë me planin e veprimit të Qeverisë. Mendoj se këto, edhe “A” edhe “B”, rivitalizimi dhe përfundimi i tyre deri në vitin 2017 do të kenë një rëndësi të madhe që të jenë në pronësi të Qeverisë, gjegjësisht të shtetit të Kosovës.

Është me vend strategjia lidhur me kapacitetet ... energjetike dhe atë çka planifikohet si strategji, sikur që ka të bëjë edhe me burimet e ripërtëritshme dhe ngrohjen qendrore dhe gazin natyralë, që po ashtu janë pjesë të një strategjie, që mendoj janë parashikime të drejta.

Por kemi këtu, te grupi i dytë, që vërejtjet tona parimore kur kemi të bëjmë me Kosovën, me potencialet dhe kapacitetet e reja. Lidhur me këtë mendoj që ne e përkrahim strategjinë, gjegjësisht politikën që të kemi në strategji që është 1000 megavat, plus 1000 megavat, e jo sikurse plani i veprimit, që nuk është aktualisht pjesë e debatit, por që realisht në terren ndodh, pra 500 plus 500.

Plani i privatizimit të “Kosovës B”, e cila është në kuadër të paketës së re, ne mendojmë që është gabim dhe duhet të tërhiqet dhe nuk duhet të lejohet që të vazhdohet më tutje me këtë projekt dhe me këtë aktivitet aktualisht. Prandaj, në strategji duhet të ndërtojmë atë politikë që është e thënë, pra të mos krijojmë monopol, nga monopoli shtetëror të kalojmë me një monopol privat, si dhe mos ta humbim këtë aset, i cili është aset i Qeverisë, i vendit, sepse mendojmë që gjenerimi nuk është problemi aktual në Kosovë, nuk është prodhimi i energjisë elektrike, nuk është “Kosova B” problemi që ne nuk kemi energji elektrike. Janë faktorë të tjerë dhe janë ndërmarrje të tjera të më vonshme për ristrukturim, të cilat krijojnë humbje mbi 50%, përdërisa ne e kemi prodhimin me ato kapacitete teknike, plus rivitalizimi që duhet të ndodhë. Pra, ne nuk do të kemi problem sa i përket 680 megavatëve të “Kosovës B”. Po, realisht ndodhë pastaj, humbjet komerciale, humbjet teknike, gjithçka tjetër që s’ka të bëjë pas ristrukturimit me “Kosovën B”. Prandaj, ekskluzivisht është qëndrim yni i prerë që “Kosova B” të mbetet deri në vitin 2017, ashtu qysh është në strategji dhe të vepohet pra nërskamë ose mbas dore, sikurse që është duke vepruar tash Qeveria, sepse do të kemi humbje të mëdha për buxhetin e Kosovës, do të kemi humbje të mëdha, ashtu siç është planifikua që ajo të kthehet në një..., ky aset të shndërrohet nga 700 megavat t’i jepet dikujt për 20%, në qoftë se atje ndërtohen 500 megavat, vlerësoni pra se çfarë humbjesh të mëdha do të ketë vendi. Pra, ky mashtrim i madh në planin e veprimit aktual duhet të ndërpritet dhe Qeveria ka për obligim ta zbatojë strategjinë e jo të veprojë jashtë strategjisë, qysh është duke vepruar.

Edhe atë çka ishim pajtuar, është politika mjedisore lidhur me lokacionin që u përmend. Shumë më mirë do të ishte që ndërtimi i kapaciteteve të reja të bëhet në lokacionet e “Kosovës A”. Mendojmë se të gjitha përparësitë janë atje për të ruajt ambientin, vendi jonë është i vogël, sikur që e dini të gjithë ju, do të thotë, peshën e madhe që e ka ambienti, pavarësisht se standardet e tjera do të plotësohen.

Në fund, në emër të Grupit Parlamentar lidhur me rekomandimet dhe plotësimet tona në fund të debatit, kemi pra që Qeveria të zbatojë ligjet dhe strategjinë për energjinë, të mos veprojë jashtë strategjisë për energji. Pra, asnjë plan i veprimit aktual që ka të bëjë, që del jashtë kësaj strategjie, të mos jetë pjesë e aktiviteteve të mëtutjeshme. Kjo ka të bëjë, do të thotë, me interesat që i kemi në fushën e linjitit pra dhe asetet në fushën e linjitit

lidhur me koncensionet dhe politikat që ruajnë interesat e vendit. Me “Kosovën B” që duhet të hiqet, mos të jetë pjesë e paketës “Kosova e Re”, si dhe “Kosova e Re” për të qenë, pra, nesër realisht vendi ynë akter në tregun dhe në bilancin energjetik në rajon, ku kërkojnë kapacitete të reja, të jetë 1000 plus 1000, pra 1000 megavat qysh është në strategji deri në vitin 2018, dhe më vonë 1000 megavat të tjera, për të qenë, pra, konkurrent dhe për të përmbushur ato kërkesa, ato analiza energjetike që i duhen zhvillimit ekonomik të vendit.

Dhe, rekomandimi tjetër ynë është që, realisht, strategjia legislative të jetë në funksion të zhvillimit të tregut, të konkurrencës, jo të monopolit, por edhe Qeveria ta zbatojë këtë. Në fund, pra, të kërkojmë harmonizimin dhe aprovimin e kësaj strategjie, po pasi të harmonizohen në pajtim me këto rekomandime dhe plotësime, që mendojmë se janë me interes të jashtëzakonshëm për sektorin e energjisë, për politikat e Qeverisë, për politikat e vendit, për asetet dhe pronën që duhet ta ketë shteti dhe Qeveria në kuadër të këtyre impakteve të mëdha të zhvillimit ekonomik dhe energjetik të vendit.

Prandaj, ne e përkrahim, në parim, por nuk do ta debatojmë në qoftë se nuk harmonizohen në fund përmes komisionit, grupeve parlamentare me ministrin bashkë, mund të harmonizojnë edhe atë çka e ka thënë në foltore, pra të harmonizohet në dokument dhe Qeveria më vonë të bëjë planin e veprimit dhe aktivitetin në pajtim me këtë strategji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ethem Çeku e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Jo, në emër të Grupit Parlamentar.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot para nesh kemi njërin nga dokumentet më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit tonë – Strategjinë e energjisë. Ky dokument që sot e diskutojmë, determinon të ardhmen ekonomike të Kosovës dhe të qytetarëve tanë. Për ne do të jetë tepër e rëndësishme se si do të vendosim të ecim përpara. Gabimet eventuale tona do të bëjnë që ne të mbesim prapë njëri nga vendet më të varfra në Evropë. Qeveria e tanishme nuk po tregon aftësi për t’i përdorë resurset natyrore për zhvillim ekonomik. Ajo ka mbetur peng e mosprofesionalizmit dhe inateve politike dhe vendi është duke paguar një kosto tepër të shtrenjtë në aspektin zhvillimor. Kosova po humb investitorët e rëndësishëm dhe po shndërrohet në një vend jo të preferueshëm për investimet e huaja, në veçanti për kompanitë e rëndësishme prestigjioze

Largimi po thuhet se i tërë konzorciumeve më të rëndësishme botërore që kishin konkurruar për projektin “Kosova C”, është mesazhi më i keq për zhvillimin ekonomik të Kosovës pas përfundimit të luftës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Vizionin që ne e patëm dhe që morëm mbështetjen e juaj dhe nga një pjesë e miqve tanë që punuan shumë që Kosova të dalë nga varfëria ekstreme, ky Komitet drejtues e ngulfati dhe shteti ynë vazhdon të mbet shtet i varfër. A po na mallkojnë resurset tona natyrorë, a po ndjekim politikë të gabuar dhe pa vizion që të vuajmë aq shumë, që qytetari ynë të kërkojë shpëtim jashtë atdheut të tij.

Pse ne me 1/3 e rezervave të përgjithshme të linjtit në Evropë dhe 1/5 e rezervave të linjtit në botë jemi ende vend që varemi nga prodhuesit tjerë të energjisë.

Pse dëshirojmë që buxheti ynë të shkojë me blerjen e energjisë me çmime aq të shtrenjta dhe Kosova të shndërrohet të mbetet treg për kompanitë të huaja. Kjo nuk është politika jonë. Ky nuk është vizioni për të cilën ne së bashku të gjithë punuam dhe ne duhet të ndërpresim këtë formë të keqe të menaxhimit të resurseve natyrore. Po ta analizojmë përvojën e zhvillimeve ekonomike të shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë, të Francës, të Gjermanisë dhe vendeve Skandinave, tregon më së miri se sa ndikojnë resurset natyrore në procesin ekonomik dhe në fuqizimin e shtetit.

Politikat e kësaj Qeverie, të këtij Komiteti drejtues dhe të një pjese të këshilltarëve ndërkombëtarë dhe një pjesë të këshilltarëve ndërkombëtarë, po e potencojë, po bëjnë që e ardhmja e vendit tonë të jetë me plotë pikëpyetje.

Të nderuar kolegë të mi,

Ka ardhur koha që të ndërtojmë politika konsensusuale për progresin ekonomik të vendit tonë. Është koha që ky parlament të merr përgjegjësinë që i takon në fushën ekonomike dhe të hartojë strategji të cilat i shërbejnë të ardhmes të vendit tonë. Kjo klasë qeverisëse duhet të lë politikën e inateve dhe të kthehet në ndërtimin e ekipeve profesionale që ndihmojnë që Qeveria jonë të marrë vendime të duhura.

Strategjia e prezantuar sot është dokument i vjetër që nuk i përgjigjet realitetit kohor. Bazohet në një kornizë ligjore, e cila është në proces të ndryshimeve. Për një pjesë të ligjeve që rregullojnë sektorin e energjisë, Kuvendi i Kosovës nuk e ka dhënë dritën jeshile. Kjo strategji nuk është në favorin e zhvillimit më dinamik të ekonomisë së Kosovës, nuk është në favorin e krijimit të parakushteve për ngritjen e të hyrave buxhetore, nuk krijon parakushte për vende të reja të punës, nuk i krijon Kosovës zë të fuqishëm rajonal në sektorin e energjisë.

Vonesat në realizimin e ndërtimit të blloqeve të reja, që ishte kërkesë imperative e Strategjisë 2005 – 2015, kanë shkaktuar humbje për ekonominë kosovare, humbjet totale llogaritet të jenë rreth 500 milionë euro në vit.

Kjo strategji që është sjellë sot para nesh, nuk është në harmoni me politikat e ndjekura nga Komiteti drejtues i Projektit “Kosova e Re”, udhëheqës i së cilës është vet sponzoruesja e kësaj strategjie. Në këtë kontest, derisa në këtë strategji planifikohet që kapacitetet e reja të ndërtohen në dy faza: 1000 plus 1000 megavat, Komiteti drejtues ndjek politika në ndërtimin e kapaciteteve 500 megavat, me mundësi të ndërtimit edhe të 500 megavatëve të tjerë më vonë. Prandaj, ose le të ndërrohet strategjia, ose le të ndërrohet projekti që është duke u implementuar në terren.

Strategjia nuk është në harmoni me bilancin energjetik të Kosovës dhe parashikimet e kërkesave për energji në vitet e ardhshme. Përkundrazi, edhe pse kërkesat për energji nga viti në vit pritet të rriten, sidomos në sektorin banesorë, bujqësisë, industrisë, shërbimeve dhe transportit, vizioni i kësaj strategjie është komplet në shpërputhje me vizionin e qytetarëve të Kosovës për zhvillim ekonomik. Rrjedhimisht, ne do të mbesim përsëri blerës të energjisë elektrike dhe do të shpenzojmë miliona euro nga buxheti ynë.

Sa i përket “Kosovës së Re”, strategjia parasheh që ajo të futet në punë në vitin 2015, ndërkohë që jemi në tremujorin e parë të vitit 2010 dhe ende nuk është përcaktuar pakoja tenderuese e projektit. Ne parashohim që në skenarin më të mirë, projekti të fillojë të realizohet në vitin 2011 për shkak të parapërgatitjeve që duhet të bëhen dhe negociatat për investitorët e përzgjedhur. Ndërmjet kësaj periudhe, strategjia nuk parasheh asnjë masë afatmesme, e cila do të mbulonte kërkesat e Kosovës për energji. Deri në hyrjen në prodhim të “Kosovës së Re”, Kosova vazhdon të blejë energji me çmime të larta, e cila për 5 vite të ardhshme mund të shkojë në qindra miliona euro.

Vendosja e “Kosovës B” në një pako tenderuese me blloqet e “Kosovës së Re” përfundimisht e mbyllë konkurrencën në Kosovë në sektorin e energjisë. Kështu, do ta shndërrojë sektorin energjetik të Kosovës nga një monopol shtetëror, siç është sot, në një monopol privat. Aty ku vendosen monopolet, dihet se çfarë çmimesh do të kemi. Kjo strategji ka mungesë të të dhënave lidhur me përfitimet e hyrjes në pako të “Kosovës B” në “Kosovën e Re”.

“Kosova B” prodhon energji elektrike rreth 3.200.000 kilovatë orë. Dhe, po t’i kthejmë në financa, në aspektin financiar me çmimin e faturuar që ia bëjmë ne konsumatorit, është rreth 200.000.000 euro në vit vlera e prodhimit të energjisë nga “Kosova B”. Dhe, në qoftë se vendosim 200.000.000 euro për t’i fituar 25% të aseteve, atëherë shohim se ky koncept është i gabuar që e kanë propozuar këshilltarët ndërkombëtarë.

Problemi tjetër shumë i madh është se informacionet që sot duhet t’i kishim rreth marrjes së një vendimi të tillë na mungojnë dhe, si e tillë, është e vështirë të përcaktohem a duhet apo si duhet të trajtojmë këtë problem.

Dhe, problemi i dytë i madh, në qoftë se në strategji është paraparë mbyllja e blloqeve të “Kosovës A”, që parimisht po e them që duhet të mbështet deri në vitin 2015. Po llogaritni, e mbyllim “Kosovën A”, i futim në një pako dhe i privatizojmë blloqet e “Kosovës B”, do të kemi rreth 5000 punëtorë në asistencë sociale. A është Qeveria e përgatitur për t’i trajtuar 5000 punëtorë që kanë të bëjë me asistencë sociale, a kemi buxhet për t’i trajtuar ata njerëz në mënyrë dinjitoze, do të thotë, po hyjmë në një rrugë të një problemi të madh social.

Problemi tjetër është privatizimi i Distribucionit. Kolegë të nderuar, ne kemi marrë një vendim që para se të hyjmë në procesin e privatizimit të Distribucionit, Qeveria së bashku me një IFC-në, si partner që e ka bërë, duhet të bëjë një studim a duhet të bëjmë dhe çka fiton Kosova në qoftë se e privatizojmë Distribucionin. Cili është profiti i Kosovës dhe çka arrijmë me privatizimin e Distribucionit. Ne nuk jemi kundër hyrjes së kapitalit privat, por jemi për të bërë analiza të duhura çka fiton Kosova në qoftë se hyn në privatizimin e Distribucionit.

Sa i përket shfrytëzimit të Minierës së Sibovcit, e cila përafërsisht ka një vlerë rreth një miliardë tona lignit, të cilët po t’i shumëzojmë herë 7 euro, herë 8 euro, deri në 10 euro, është diku përafërsisht 7 – 8 miliardë vlera e Minierës së Sibovcit. Këtu ende, në strategjinë që sot është dërguar këtu ta diskutojmë, ende nuk e dimë, a duam ta japim gjithë minierën, duam vetëm një pjesë, siç u cek më herët, apo duam ta trajtojmë në një formë tjetër. Bile në strategji, të them, është lënë tepër hapur dhe e pa definuar çështja e Minierës së Sibovcit.

Dhe, në fund, edhe ne si komision e kemi debatuar shumë gjatë se si mund të ndihmojmë që strategjia që sot po e diskutojmë, të jetë në harmoni me projektin. Ne sot po e diskutojmë strategjinë...

KRYETARI: Dy minuta ia vazhdoni kohën, regjia!

ETHEM ÇEKU: Në realitet, ne sot po e diskutojmë strategjinë, a projekti po zhvillohet në konjunktura tjera zhvillimore. Prandaj, edhe një herë e ftoj Parlamentin, ftoj institucionet, Qeverinë që të bëjnë harmonizimin e strategjisë me projektin. Nuk mund të ecën strategjia në raporte të ndryshme me projektin.

Dhe, çështja tjetër që është tepër e rëndësishme, u përmendën asetet. Ju lutem, ne posedojmë, do të thotë, Kosova, Qeveria e Kosovës e ka Minierën e Sibovcit me një vlerë të përgjithshme që kap një shumë rreth 10 miliardë euro. Me një minierë të tillë, që Qeveria e Kosovës e ka të drejtën e licencës, të thuhet se ne do të marrim në pakon e re një vlerë prej 20 deri 20%, mendoj që është gabim si sugjerim për Komitetin drejtues për projektin “Kosova e Re” dhe me këtë projekt ne de fakto nuk jemi duke bërë zgjedhjen e problemit në fushën e energjisë elektrike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar Strategjinë e energjisë për periudhën 2009 – 2018, e cila na është ofruar dhe paraqet një dokument i cili mund të them se është riparuar, mirëpo absolutisht është ajo strategji e cila është miratuar në vitin 2005.

Mirëpo, së pari, para se të shkoj në analizë më detale të strategjisë, mbasi e kemi ministren këtu prezentë, dua të sqaroj disa pyetje për Qeverinë.

1. Pse është vonuar deri tash dhe kah po shkon ndërtimi i kapaciteteve të reja,
2. Pse po mungon transparenca për projektin që është i strategjisë së rëndësishme për Kosovën, kur dihet se projekti “Kosova e Re” dhe privatizimi i Distribucionit dhe Furnizimit janë duke shkuar paralel me mungesë të ligjeve, të rregullativave, të procedurave të definuara qartë, dizajnit, modelit të tregut të energjisë elektrike, rregullat e tregut, ndarja e qartë në mes të subjekteve me ndarje ligjore, sa është në gjendje sistemi elektro-energjetik i Kosovës të bëjë përballimin e tanishëm të ndërtimit të “Kosovës së Re” 500 plus dikur më vonë 500 megavat, a është bërë një analizë e mirëfilltë e ekspertëve brenda Ministrisë së Energjisë apo brenda Qeverisë?
3. Pse nuk është paraqitur një raport i planit implementues për periudhën paraprake pasa se të fillohet me rishqyrtim të strategjisë së energjisë, kur dihet se kjo strategji edhe më parë nuk është implementuar në total, si ka qenë e miratuar në Kuvend të Kosovës?

Tek përcaktimi i prioriteteve për eksplotim të linjitet, prioritetet caktohen ad-hoc, nuk sqarohet qartë në bazë të cilave parametra do të bëhet renditja e prioriteteve. Te kapitulli i gazit dhe i naftës, nuk jep vizion strategjik se si duhet vepruar, por shprehimisht thuhet se është bërë shumë për sigurim të rezervave të detyrueshme, pa e dhënë asnjë sqarim sa duhet dhe si duhet krijuar këto rezerva.

Tek vendosja e Termocentralit “Kosova e Re”, rekomandohet lokacioni i tij të jetë “Kosova A”, a është bërë një ekspertizë e mirëfilltë, çka do të ndodhë me blloqet e Termocentralit “Kosova A” dhe sa do të kushtojë kjo pjesë kur të rikultivohet dhe të përmirësohet me kushte mjedisore, kurse thuhet e kundërta, ndërsa tash parashihet ndërtimi i termocentralit apo i bllokut të ri të Termocentralit “Kosova e Re” afër Termocentralit “Kosova B”, vendime është shumë konfuze të Qeverisë për këtë projekt.

Zgjedhja e teknologjive, thuhet dy teknologji në dispozicion, pa përmendur se a ekzistojnë më shumë se dy teknologji të aplikueshme për djegie të linjitet dhe që janë shumë më të avancuara se këto që janë përmendur.

Tek mbështetja buxhetore, jepen shifra marramendëse të ndara nga buxheti i Kosovës dhe nuk tregohet saktë se a është kërkuar ndonjëherë nga Qeveria se kah kanë shkuar këto të holla dhe si kanë shkuar në Korporatën Elektro-energjetike të Kosovës.

Tek Projekti “Kosova e Re” edhe në këtë strategji, sikurse edhe në atë më herët, ndoshta nuk sqarohet shumë qëllimisht çështja e kapacitetit të Termocentralit “Kosova e Re”, thuhet 1000 deri më 2018, ndërsa 1000 tjera figurojnë prapë këtu. Apo është problemi se duhet të startojmë me 500 plus 500. Gjithashtu, nuk është ajo që thuhet në strategji për Termocentralin “Kosova B” i cili në pakon tenderuese i ofrohet ofertuesit si pjesë e pakos, e këtu flitet për vitalizmin e tij përmes partneritetit publiko-privat. A është bërë një analizë paraprake nga Qeveria për futjen e Termocentralit “Kosova B” në pakon tenderuese me Termocentralin “Kosova e Re” kur dihet se Termocentrali “Kosova B” jetëgjatësinë e ka deri në vitin 2030 dhe a bien ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës për ekonominë e lirë të tregut. AKR-ja nuk e mbështet që në pakon tenderuese të jetë Termocentrali “Kosova B”.

Tek marrëdhëniet dypalëshe mes Serbisë, parashihet ngritja e një trupi profesional, që do të vlerësonte saktë dëmet e shkaktuara nga shteti i Serbisë, por edhe pas luftës, e jo veç të përmenden këto janë rekomandime nga Grupi Parlamentar, kur dihet se edhe tani në pjesën veriore të Mitrovicës funksionon Elektroekonomia e Serbisë dhe shteti i pavarur i Kosovës është shpall në vijat kufitare të cilat kanë qenë edhe përpara.

Tek pjesa që flitet për konferencën e donatorëve, flitet që është i rëndësishëm ky sektor, ku është dashur të ceket si rekomandim, do të kemi mundësi të investitorëve dhe klimë të rëndësishme ligjore për investitorë, që të kem investitorë më të rëndësishëm. Te pjesa që ka të bëjë me parashikimet për energji, nuk e di se si është futur skema qysh në vitin 2015 Hidrocentrali i Zhurit me kapacitete 398 megavat energji elektrike, kur dihet se ky më shumë është një lloj dëshire dhe nuk është ... për shkak të koeficientit të ulët të shfrytëzimit të cilat i ka Kosova.

Tek sistemi i bartjes dhe transmisionit, synim kryesor do të jetë shpëputja nga varshmëria teknike prej Serbisë, e jo të jepen pa koncepte si infrastrukturë e qëndrueshme, kur ne e dimë se pësojmë nga Serbia për shkak të transmisionit.

Përfundimisht, mendoj se kjo strategji duhet të ishte më transparente për arsye se janë duke shkuar dy projekte: Projekti i Termocentralit “Kosova e Re” dhe Projekti i privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit.

Mirëpo, Grupi Parlamentar i AKR-së, pikë së pari jep rekomandimet, të cilat i potencova si çështje qendrore për përmirësimin e sektorit të dytë të rëndësishëm në Kosovë, pas sundimit të ligjit, të sektorit të energjisë, të merren rekomandimet dhe ky dokument strategjik të aplikohet për të mirën e qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Ibrahim Gashi

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, shefi i Grupit, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Fillimisht, shpreh qëndrimin kundërshtues të Grupit Parlamentar të LDD-së për Strategjinë e energjisë dhe një vlerësim i tillë apo një qëndrim i tillë kundërshtues mbështetet në gamën e madhe të argumenteve të cilat bëjnë që ky dokument sot të kundërshtohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

LDD vlerëson se ky dokument apo kjo strategji nuk merr për bazë interesin shtetëror të Kosovës. Kjo strategji apo ky dokument, si i tillë, nën dy, është në shërbim ekskluziv të grupeve të caktuara të interesit vendor dhe ndërkombëtar. Kjo strategji është, në fakt, për humbjen e pasurisë së Kosovës dhe të resurseve të saja. Në këtë formë, shteti i Kosovës do të jetë qiraxhi pa pronësi në resurset e saja strategjike. Dhe, kjo strategji apo ky dokument që kemi për bazë, do të krijojë obligime të mëdha për gjeneratat e sodit dhe gjeneratat e ardhshme të vendit dhe këto obligime do të jenë pa rrugëdalje.

LDD vlerëson se vizioni i Strategjisë për zhvillimin e energjisë së vendit, e që ky dokument nuk e ka, do të duhej të ishte i orientuar në tri shtylla kryesore, që në fakt është vizion i shteteve moderne.

1. Definimi i interesit shtetëror të Kosovës. Në këtë dokument asnjë fjalë nuk mund ta gjeni se cili është interesi shtetëror i vendit.
2. Definimi i qartë i principeve të zhvillimit të qëndrueshëm të energjisë, që nënkupton realizimin e objektivave që obligon ekuilibri energji – mjedis. Këtu, pa dyshim, do të duhej të përfshihej konkurrenca dhe siguria në kuptimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Dhe,
3. Implementimi i kritereve dhe standardeve të BE-së, me fokus të veçantë – uljen e misionëve karbonike.

Qasja e këtij dokumenti ndaj resurseve energjetike aktuale dhe atyre që synojë të ndërtohen në të ardhmen, e bën këtë dokument edhe më të papranueshëm. Vetë mocioni shthurje e KEK-ut dhe përmbajtja e një koncepti të tillë nuk është strategji e reformave, të nderuar deputetë, por është rrugë e falimentimit, është koncept i mohimit të kontributeve dhe attributeve vendore në këtë sektor e që, fatkeqësisht, një qasje e tillë po na përcjell në të gjithë sektorët e jetës në vend.

LDD vlerëson se cilido hap që do të ndërmerret për kapacitetet aktuale energjetike, pa nxjerrjen e Ligjit për privatizimin e KEK-ut dhe pa një vlerësim real të aseteve, do të ishte një gabim i madh me pasoja të rënda. Projekti “Kosova e Re” dhe kur flasim për të, të nderuar deputetë, duhet të jemi shumë të përgjegjshëm në këtë aspekt. LDD vlerëson

se duhet të vendoset një kornizë, prej të cilës nuk mund të largohemi, për të mos thënë një vijë të kuqe, me të cilën identifikohen interesat e shtetit të Kosovës. kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e shtetit në pronësi kur bëhet fjalë për përqindjen e aksioneve në ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe për sasinë e kapaciteteve gjeneruese.

Qeveria e Kosovës nuk duhet të lejonte, ajo çka është thënë vazhdimisht në publik, që miniera e re apo Miniera e Sibovcit t'i jepet në shfrytëzim apo pronësi investitorit të ardhshëm, për vetë faktin se një resurs i tillë është me interes strategjik për vendin.

Qeveria e Kosovës nëpërmes kësaj miniere mund të siguronte bashkëpjesëmarrjen në këtë investim dhe ajo çka është më kryesorja, do të mbante nën kontroll të gjitha impaktet negative që vinë nga kjo zonë industriale. Përndryshe, Republika e Kosovës sot dhe në të ardhmen do të paguaj një faturë të lartë për shëndetin e popullatës.

Ajo tjetra çka bie në sy në këtë strategji, është plani për zgjerimin dhe shfrytëzimin e kapaciteteve gjeneruese, por jo për planin për lëvizjen demografike apo zhvendosjen e popullsisë.

Pjesë e këtij dokumenti që i referohet mbrojtjes së mjedisit, është shumë problematike, për tmos thënë për nivelin e këtij dokumenti se është në nivelin shkollor, me tendencë maksimale të minimizimit të problemeve.

Të nderuar deputetë,

Caktimi i lokacionit për ndërtimin e Termocentralit të ri “Kosova e Re” nuk është çështje teknike, është çështje strategjike. Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta ketë parasysh.

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta dijë se eksploatimi i linjitit është tepër i shtrenjtë, nëse kemi për bazë refleksionet që jep ajo. Kërkon investime dhe krahas degradimit të mjedisit sjell efekte apo impakte të shumta negative, jo vetëm për shëndetin e popullatës, por dëmton bujqësinë, siç është thënë vazhdimisht, dhe varfëron fondin e ujit në vend, edhe ashtu mjaft të varfër.

Dhe, për të gjitha këto, Qeveria e Republikës së Kosovës, të nderuar deputetë, duhet të japë përgjigje nëpërmjet të një dokumenti të quajtur strategji, të cilin fatkeqësisht nuk e kemi përpara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, është paraqitur Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsjedavajući!

Dozvolite da pozdravimo inicijativu ove debate o Energetskoj strategiji za period 2009, ili bolje rečeno 2010. godine, jer mi smo u 2010-toj. O ovome razgovaramo do 2018. godine. Mi smo ponuđena dokumenta koja su nam data u pismenoj formi, Energetska strategija, u Parlamentarnoj grupi „7+“ analizirali i kao i prethodne kolege, u načelu normalno pridržavamo ponuđena rešenja, ali uz znatno veći broj primedaba koje smatramo da su argumentovane. Mi shvatamo da je glavni interes dat na analizi energetskih izbora, koji se baziraju na lignitu, kao što se predviđa u strategiji i dalje kao osnovni energetski izvor.

Poznato je da je lignit bez obzira na navođenje da je to kvalitetna vrsta uglja, ipak je to najslabija vrsta uglja, daleko kalorično zaostaje iza mrkim, a pogotovo za kamenim ugljem. Mislim da bez obzira na to što su povoljni resursi kada su u pitanju površinski kopovi ili nedovoljno velika dubina za njegovo korišćenje, ali se ne možemo u potpunosti složiti zašto se vrlo malo govori o hidro potencijalu, vrlo je malo podataka dato o planiranoj hidroelektrani Žur, zašto se ne polazi sa stanovišta da Kosovo nije dovoljno bogato površinskim vodama. Mi ako nemamo velike reke, onda ne možemo ni praviti velike hidroelektrane, a vrlo se malo govori o mini elektranama. Nimalo ne koristimo iskustva o izgradnji mini elektrana u bližem okruženju, kakva je Slovenija i Bosna i Hercegovina ili o drugim alternativnim izvorima energije. Naime, ovde stoji podatak da Svetska banka podržava izgradnju i dalja istraživanja alternativnih izvora energije, pogotovu bio-energenata, kakvi su vetar, solarna energija i takao dalje. Mislim da treba tu posvetiti više pažnje i iskoristiti šansu ulaganja međunarodne zajednice s obzirom da se ponovo pominje i Donatorska konferencija od 2009.godine, u Briselu, pardon 2007. godine, U Briselu. Kažem, malo se o tome govori zato što većim ulaganjem u alternativne izvore energije, imaćemo manja ulaganja u zaštitu životne sredine, jer zna se koliko ugalj i druga čvrsta goriva, evo i kolega pre mene je govorio o posledicama ne samo po poljoprivredu, nego i po hrani i po teku zagađenja tekućih voda i tako dalje, i tako dalje. Socijalna politika, preseljenja stanovništva, sve to kažem izaziva ogromne troškove.

Ja bih ovde takođe rekao da obnovljivi izvori energije u svetu tehnološki se daleko odmaklo, recimo sa korišćenjem solarne energije. Vi znate, samo primer recimo Holandije, a u novije vreme Nemačke, Švajcarske i nekih drugih zemalja kada je u pitanju energija vetra. Mi smo svedoci da smo poslednjih meseci videli nekoliko instaliranih mini vetrenjača na Golešu, nedaleku od Aerodroma. Nikada nismo dobili podatak šta je sa njima i kakva je budućnost energenata na vetar, s obzirom na to da je Kosovo, ja mislim znajući dobro geografiju Kosova, da Kosovo bi moglo znatno više da ima koristi, recimo od energije vetra, znamo da su ulaganje u vetrenjače takodje velika, ali zato nemamo kasnije ulaganje u zaštitu životne sredine.

Mi u svakom slučaju ćemo podržati ovu strategiju, ali stavljamo do znanja da u njoj ima još mnogo, mnogo toga što treba da se uradi, treba još mnogo snage i ulaganja u permanentnoj daljoj aktivnosti na njenoj kvalitetnoj doradi, dopuni u usklađivanju, jer ne smemo smetnuti sa uma kojom brzinom se razvija nova tehnologija, tehnološki proces. Poznato je da je energija ustvari pokretač društva i privrede i celokupnog razvoja, kažem uvažavajući ponuđena rešenja, mi stojimo na stanovištu da treba dalje raditi na istraživanju na novim rešenjima i u to ime, eto mi dakle ovu strategiju podržavamo na način kako sam to rekao u ime Parlamentarne grupe „7+“. Hvala, vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Duhet ta ndërpresim për shkak të mungesës së kuorumit. Lus regjinë që t'i bie ziles, ndoshta janë këtu deputetët, përndryshe nuk mund të vazhdojmë. Ka më pak se sa që mund të vazhdojnë diskutimet, janë 38 deputetë.

(Reagim nga salla)

Po, po, e ndalem veç nuk deshëm ta ndërpresim. Ju faleminderit!

15 minuta pauzë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Ju lutem, kolegë, i zini vendet! Mund të vazhdojmë.

Shërbimi administrativ na thotë se kemi kuorum për të diskutuar. Vazhdojmë me diskutimet.

Në emër të Grupit Kuvendor të SLS-së, nuk është paraqitur askush për diskutim.

Shkojmë te Grupi për Integritet. Deputetja Vezira Emrush e ka kërkuar fjalën.

VEZIRA EMRUSH: Hvala, lepa na datu reč!

Pozdravljam Vladu,

Predsedavajućeg Skupštine i cenjene kolege,

Danas imamo pred sobom strategiju o energiji na Kosovu od 2009 do 2018. godine. U ovoj strategiji opisan je, ako smo pažljivo čitali, srednjoročni i dugoročni plan razvoja ovog sistema na Kosovu.

Međutim, mi kao grupa pažljivo smo razmatrali ovaj izveštaj Vlade, ali kao grupa moramo da kažemo da smo prilikom pažljivog analiziranja, naišli na neke stvari koje su tipično školski dati u ovoj strategiji. Ova strategija je pisana sa namenom da zadovolji, da kažemo papire, a ne kosovske potrebe. Zašto ovo kažem? Znači, kao dokument nema parametre i kvalitetne namene ili ciljeve za ostvarivanje strategije.

Zašto je strategija rađena na jako nestručan način, sa jako malom analizom postojeće situacije kada je u pitanju proizvodnja, prenos, distribucija i potrošnja svih energenata. Daje se, opet kažem, školski osvrt na bogatstvo lignita sa kojim raspolaže Kosovo. To znaju i učenici u osnovnoj školi da Kosovo ima 14,5 milijarde lignita, bogatstvo lignita i ovde čak nisu ni dali da je 250 miliona od ovoga iskorišćeno u bazenima Kosova i Dukagjini. Kada se radi o kapacitetima proizvodnje električne energije, opisani su blokovi A i B sa ukupnom instalisanom snagom od hiljadu i po megavata i koji su praktično zastareli, izgrađeni 1962. godine, i 1984. godine, gde im je vek proizvodnje u fazi dotrajanja. Više puta se vršio remont istih sistema i potrošeno je hiljadu i po dolara, milijardu i po dolara na sanaciji. I pored toga što su menjani generatori, Blok B radi sa smanjenjem proizvodnje i došli smo ponovo do znanja da su se subvencionisana sredstva i sredstva donatora koristila bez kontrole. Da je remont vršen našminkanom opremom, ne novom, zato što bi nova oprema bila u funkciji i produžila vek istih blokova za najmanje 20. godina, a ne da smanji proizvodnju. Mora se rešiti znači problem proizvodnje, problem prenosa, gde su uska grla. Mora se ovo na terenu da se prepoznaju uska grla, da je distributivna mreža zastarela, da je premala sekcija provodnika i da su neophodne investicije u svim naponskim nivoima od 04 do 220 kilovata.

Izgradnja inter-konektivnog sistema od 400 kilovata i povezivanje Kosova preko tog sistema sa svim zemljama u regionu, je pre potrebna i nastup na tržištu energije prilikom kupovanja i izvoza energije, normalno kupuješ od najjeftinijeg dobavljača. Izgradnja kada se radi o izgradnji „Kosova C“ sa strateškim partnerom, mora da se obavi ova izgradnja, gde će strateški partner biti zainteresovan u vidu koncesije. Isto je to sa He-Žurom i potrebna je, kao što smo rekli, obnova blokova u Termoelektrani „Kosovo B“

Ovo kažem iz razloga zato što je jako malo definisano i vidimo da se velika sredstva izdvajaju, opisana je kosovska kompanija KEK, koja ima monopol na tržištu i koja se

ponaša monopolistički i koja zloupotrebljava taj položaj kada su u pitanju sopstvena sredstva koja treba da zaradi i sredstva koja troši iz budžeta.

Ova kompanija nema, prvo, dobar menadžment, nema stručnu radnu snagu, ova strategija se ne bavi sa ljudskim faktorom. Ima višak radne snage. Ja ne znam dali su ovde kolege informisane, mi imamo matične brojeve u elektroprivredi 11.000-12.000 hiljada. U pitanju je 12.000 hiljada radnika. Malo se analiza vrši u okruženju, kakve su kompanije, kakva postrojenja imaju, koja zapošljenja, koji ljudski resurs, znači ova strategija nema prave analize. Bez prave analize, bez ostvarenja na terenu, bez situacije kakva jeste, mi možemo da pišemo strategije, ali da ostvarimo, nema tendenciju ostvarivanja.

Ja, kao poslanik, posebno bi htela da dam doprinos, da imam jako malo vremena, da ima puno da se kaže kada je u pitanju energetska strategija Kosova, gde bi mogli da budemo uspešni zato što je energija baza za razvoj ekonomski, u svim sferama: građevinski, ekonomski, poljoprivreda, sve se zasniva na energiji, privlačenje investitora, zapošljavanje, otvaranje novih radnih mesta, sve je ovo, da kažem, temelj energija, i iz ovog razloga mi bi se ovim sektorom morali malo više da se pozabavimo, da angažujemo ne samo strane stručnjake, nego i domaće stručnjake koji će analizirati kompanije i regione. Zašto kažem? Kada je u pitanju alternativna energija, Vlada ne bi trebala samo da se osvrće na velike kapacitete, morala bi da iskoristi i resurse, vodene resurse, resurse vetra, sunca, gde bi smanjila potrošnju, zato što je danas znamo od 17 do 18. miliona dnevna potrošnja Kosova. To bi mogli u letnim mesecima sa sunčanom energijom, sa emisijom vetra da uradimo tamo u regijama gde su nerazvijene regije, da ova Vlada posveti pažnju nerazvijenim regijama gde ima potencijalni kapacitet, kao što su regije Opoja, Gora, Župa, gde može da dođe do proizvodnje od 50 kilovata kapaciteta energije u malim hidro elektranama, koje su na tržištu, da vam kažem, jako jeftino od 3 do 5 miliona.

Ovim se pitanjem Vlada malo bavi, prioriternim stvarima, ne selektira probleme koji su na terenu, jedino radi na velikim kapacitetima. Kada je u pitanju naplata, ja moram da kažem da je sada ovo na terenu, da se isto ne analizira dovoljno. Na terenu je da ljudi plaćaju zadnji račun i 10% od ukupno, a znamo da imamo dužnike koji nisu plaćali punih 10 godina, pa smo te dužnike privilegovali, ali zato vršimo diskriminaciju platiša, građana platiša. Sa ovom politikom Vlada ne bavi. To je jako diskriminatorna politika naplate.

Pod drugim, kada su u pitanju socijalna davanja od strane Vlade, isto su oduzeta stečena prava socijalnim građana koji su koristili od 500 do 800 kilovata mesečno, a sada Vlada izdvaja pare, kao što znamo prošle godine, 4,5 miliona. Mogu slobodno da kažem da milion i po od toga nije sproveden, ni 10, 20% socijalni slučajevi nisu skinuti računi, pare negde zalutaju, nestanu i od toga, ako ne napravimo dobru socijalnu šemu, da to bude u kilovatima, ne u novcu koji korporacija dobija i dalje nemamo kontrolu, znači ugrožena je kategorija socijalnih građana...

KRYESUESI: Kolege deputete, lidhur me strategjinë, të lutem!

VEZIRA EMRUŠ:...Ovo je sve u vidu strategije, zato što imate, evo vidite mere koje će se preduzeti za socijalna davanja, evo ovde je isto data pažnja na to i opisano. Ja sam samo htela da konkretizujem stvari, da dam neke pravce, da mi možemo da budemo

pozitivni i kao poslanici i kao Vlada i mislim da ne smeta gospođi ministarki, ne bi trebalo da smetaju ovakve preporuke. Jedna od vidnih preporuka koju moram da dam, je decentralizacija energetskeg sistema, i to na proizvodnju, prenos, potrošnju i distribuciju. Sistem je jako...

KRYESUESI: Edhe një minutë deputete, flet në emër të Grupit.

...sistem je jako decentralizovan. Zašto kažem decentralizacija? Zato što bi imali nadgledanje u funkcionisanju svake distribucije i svakog sistema od proizvodnje do prodaje i potrošnje, i to bi bilo efekta kada su u pitanju koje su kompanije danas funkcionalne, koje nisu po gradovima i po opštinama. Znači, decentralizacija je obavezna i ima velike zloupotrebe kada je u pitanju nabavka, javna nabavka. Molim vas, ja ne kažem da nije ovo strategija, mi moramo u svakom polju, u svakom sektoru da se brinemo kako da povećamo nadzor nad sektorima i kako da smanjimo vidove korupcije. Hvala, lepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete, hvala!

Shkojmë me radhën e deputetëve të paraqitur për diskutim, ashtu siç u votua, kohëzgjatja 5 minuta. Ju lutem që ta respektoni! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Strategjia e përgatitur nga Ministria e Energjisë dhe e Minierave nuk është asgjë tjetër përpos një shkrim studentesk, që me shprehje akademike tenton t'i anashkalojë problemet politike që sjellë kjo strategji.

Ne, si deputetë, duhet të votojmë diçka që i sjell lehtësi biznesit, të mira Kosovës e jo të futemi në analizat ..., që më duhet të them se për shumicën e deputetëve nuk kanë ndonjë kuptim esencial.

E nderuara ministre,

Të lutem, fillo që puna jote të fokusohet në politikë dhe krijimin e politikave për shfrytëzimin efikas të resurseve të Kosovës, për paraqitjen e Kosovës si një shtet serioz para partnerëve ndërkombëtarë, e jo si një grup matrapazësh të tregut, që luajnë me pasuritë publike si të ishin ato të një vendi që është nën koloninë e grupit të juaj dhe e juaj, si ministre, dhe të atyre që të rrethojnë.

Kjo strategji që sot e ke sjellë në Kuvend, për diskutim, i largoi kompanitë me repute botërore, siç janë: RVE, CEZ nga gara e mëturjeshe. Çfarë dëmi mund të sjellë për gjeneratat që vijnë, këtë askush nuk e dinë, por me siguri se dëmet do të jenë shumë të mëdha.

Zonja ministre,

Fjala “strategji” rrjedh nga fjala greke “strategis”, që do me thënë roli i udhëheqësit të luftës dhe në luftë secili e ka nga një rol. Pra, ju lus, të na shpjegoni a është roli i juaj i fituesit apo i humbësit kundrejt juve dhe qytetarëve?

Qeveria pati thënë në fillim të saj se energjia do të jetë njëri nga prioritetet. Të gjithë kanë dashur që të besojnë se ajo ka qenë e sigurtë, kur e ka thënë një gjë të tillë, dhe se

problemet me energjinë elektrike do të tejkalohen në vitet e para të qeverisjes. Disa mund ta kenë energjinë prioritet për tejkalimin e vështirësive që qytetarët dhe ekonomia e Kosovës përballen për çdo ditë, derisa për disa të tjerë dhe këta që janë sot, mund të jetë resurs i mirë për t'u pasuruar dhe kjo e fundit e shpjegon, pse disa prej kompanive më të rëndësishme në sektorin e energjisë janë larguar prej gare për ndërtimin e "Kosovës C", më falni "Kosovën e Re". Çfarë dallimi pati kur projektit iu ndërrua emri. Në shikim të parë, ndërrimi i emrit mund të mos jetë i rëndësishëm, por në esencë e pasqyron të tërë politikën qeveritare, që tash për tash po bëhet në Kosovë, por më së miri e pasqyron gjendjen në sektorin e energjisë. E keqja është se barrën e fajësisë së përndjekjes së investitorëve serioz, duke transmetuar se kërkesat enorme në para të gatshme dhe favorët e investitorëve potencial po i bëjnë në kurriz të shpinës së qytetarëve të Kosovës, të cilët vazhdimisht janë të përulur dhe të keqtrajtuar në të gjitha format, fizikisht, por edhe psikik.

E keqja më e madhe është se po ndikohet në kulturë, në atë se si po bëhen gjërat, por mos te harrojmë, por edhe në atë se si po besojmë se është mirë të bëhen. Unë po mendoj se duhet të hapet një debat më i hapur për pjesëmarrje aktive të grupeve nga më të ndryshmet. Një gjë e tillë bëhet e dobishme kur Qeverisë t'i shkojnë fjalët në vesh të tingëllojnë, mund të mos pajtohesh, por dëgjo. Do të jetë e dëmshme përderisa mbeten vetëm duke përdorur fuqinë e ironisë. Mos u nervozoni ju atje, apo edhe ndonjë fjalë slogan të përdorur vend e pa vend. Kjo është vetëm një përpjekje e imja për të paraqitur defektet që po reflektohen nga ky dokument, që është shumë i vështirë t'i jepet emri, sepse nuk është formulim e as riformulim i Strategjisë së energjisë.

Nëse veç duhet të minimalizohen kërcënimet ndaj krizës globale, që shumë shpesh është përmendur këtu, dhe të maksimizohen mundësitë që ofrojnë resurset natyrore të Kosovës, atëherë paraqitet nevoja që Qeveria të jetë e artikuluar në politikat e veta zhvillimore. Kemi të bëjmë me çështje makro-ekonominë.

Rasti i kësaj strategjie tregon se Qeveria e Kosovës ka njerëz me tituj akademik, por nuk posedon vullnet politik për zhvillimin e vendit. Por, me sa duket, nga e gjithë storja për "Kosovën e Re", është vetëm qartësim i vullnetit politik, që unë e quaj vullnet i mirë i mbushjes së xhepave personal të Kabinetit qeveritar, fakt ky që të gjithë miqtë ndërkombëtarë po na thonë troç. Kjo mund të jetë temë e debatit më të gjerë publik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të them të drejtën, unë jam në dilemë a të flas a mos të flas për shumë arsye. Na i hëngrët nja 5 minuta për këtë debat kaq të rëndësishëm, por u thanë shumë gjëra dhe besoj që i kemi diku edhe nja 16 deputetë, të cilët presin të flasin dhe do të flasin gjëra interesante. Nuk desha të flas edhe nga fakti se ne po flasim për një strategji të gabuar, na është sjellë në shtator të vitit 2009, e deri atëherë, Qeveria tri herë e ka ndërruar mendimin, një herë me 7 tetor, Qeveria u pat deklaruar për ridizajnim, pastaj me 9 nëntor na dha një formulë 3 herë 330 megavat, dy herë 500 megavat e tjera, e tjera, pastaj me 17 dhjetor, përsëri na doli me këtë të fundit, nuk e ka ndërruar mendjen edhe më tutje, besoj se nuk do ta ndërrojnë, me dy here 500, do me thënë, edhe kjo strategji vetvetiu është

nja 4 muaj më përpara. Pra, nuk i adreson në mënyrë të saktë këto qëndrimet e Qeverisë.

Po ashtu nuk desha të flas, sepse folëm çka folëm në këtu, nuk po çon peshë, edhe ashtu Qeveria vazhdon me të veten. Sa për ta vërtetuar këtë, ja po e marrë shembull faqen 16, lexojeni, flitet për mbrojtjen e mjedisit, po e lexoj paragrafin e dytë, thuhet: “Raporti final i vlerësimit strategjik mjedisor dhe social, (madje kanë futur edhe këto shkurtesat VS MS) është përfunduar në nëntor të vitit 2008, pas konsultimeve me ekspertë dhe me publikun”. Në këtë raport identifikohen në nivel strategjik çështjet e tjera, e tjera, dhe tash të bën të mendohesh çfarë raporti është ky, kur e kemi pasur në dorë? Por, po ua rikujtoj deputetëve të nderuar, se na ka sjellë Qeveria më 20 nëntor 2008, një raport që ne patëm qeshur këtu.

Po ua lexoj çfarë raporti, do me thënë, aq i sofistikuar, ja ku e kemi. Ka qenë 140 faqe. Raporti për mbeturina, ja se çfarë shkruan aty, po e lexoj, në atë raportin VS MS, çka është kjo farë shkurtese, thotë kështu: “Mbeturinat janë lëndë komplekse edhe hetoregjene, të cilat krijohen gjatë aktiviteteve të përditshme të njeriut në punë, banesë, sipërfaqe publike, shkolla, industri dyqane”, do me thënë kështu shkruan në atë raportin e sofistikuar, që na e kanë prurë këtu si referencë. Kjo strategji është bazuar në atë strategjinë e famshme. Ja, po ua lexoj faqet tjera, thuhet për shembull, për Raportin mbi mbeturinat e letrës, dhe ja çka shkruan aty: “Grumbullimi i letrës së vjetër dhe riciklimi i saj është i rëndësishëm për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave, ruajtjen e resurseve natyrore, kursimin e energjisë dhe zvogëlimet tjera”, e tjera e tjera, apo për plastikën, atë raportin që ka edhe madje fusnota këtu. Ja këtu çka shkruan: “VS, MS është hartuar si pjesë e projektit PATL, një zot e di çka është kjo, të financiar nga WB dhe ISI. Po të mos e kishim në dorë këtë, thotë njeri ku ta dimë se sa eksperti ka punuar, se çfarë elaborati kaq i sofistikuar është dhe pastaj del aq qesharake kjo strategji...”

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Vazhdojmë me diskutuesin e radhës. Berim Ramosaj, nuk është këtu, kalojmë te diskutuesi Eset Cakolli, le të përgatitet deputeti Naser Rugova.

ESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2009-2018, është një dokument i rëndësishëm për sektorin e energjisë dhe paraqet...

(Driton Tali, reagon nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYESUESI: E verifikojmë, e verifikojmë, nuk mbetemi borxh. Vazhdon deputeti Eset Cakolli.

ESET CAKOLLI... rishikimin e strategjisë së energjisë për periudhën 2005-2015. Ky dokument është dashur të përgatitet duke u bazuar në studimet paraprake, më gjithëpërfshirëse dhe pastaj të jepen në formë më të specifikuar mënyrat dhe periudhat kohore të zbatimit të kësaj strategjie.

Synimi kryesor i kësaj strategjie është të zhvillohen dhe të zbatohen politika dhe korniza ligjore për reformim dhe ristrukturim të sektorit të energjisë në përputhshmëri me

direktivat e Bashkimit Evropian, me qëllim të zhvillimit të tregut konkurrues, të qëndrueshmërisë financiare dhe rritjen e sigurisë së furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike dhe energji tjera.

Kosova, edhe pse ka rezerva të mëdha të linjitit, diku afërsisht mbi 13 miliardë tonë dhe kapacitete gjeneruese termike të instaluara për gjenerimin e energjisë elektrike, përafërsisht 1478 megavat orë, ndërsa kapacitetet efektive gjeneruese momentale mund të prodhojnë diku 840 megavat orë, megjithatë, po ballafaqohet me mungesë të madhe të energjisë elektrike në sasi dhe cilësi dhe kjo po ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit, respektivisht në jetën e qytetarit të Kosovës.

Gjatë periudhës 200-2010 janë bërë shumë investime dhe përpjekje që gjendja me furnizim të energjisë të përmirësohet, por fatkeqësisht gjendja e përgjithshme, në këtë sektor edhe më tutje është e rëndë.

Furnizimi i sigurt dhe me cilësi të lartë të energjisë të konsumatorit është kusht themelor dhe i domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për tërheqjen e investitorëve potencial për të investuar në sektorët e ndryshëm të industrisë.

Furnizimi, transmissioni, shpërndarja, faturimi dhe inkasimi i energjisë së shpenzuar janë vështirësitë kryesore me të cilat ballafaqohet ky sektor gjatë kërkesave aktuale të konsumit.

Të nderuar, deputetë,

Edhe pse kemi dy dokumente të rëndësishme për shqyrtim: Strategjinë e energjisë dhe Raportin e progresit për vitin 2006-2008, për mendimin tim u mungojnë të dhënat e shumta, të cilat kishin për ta përshkruar gjendjen aktuale dhe pastaj të bëhen plane, projekte konkrete, me qëllim që të përmirësohen nevojat, të plotësohen nevojat për energjinë në periudhën 2008-2018.

Shumë të dhëna zyrtare flasin se humbjet teknik dhe ato komerciale janë diku mbi 50%. Shtrohet pyetja - 50% e cilës sasi të energjisë, asaj minimale apo maksimale që i nevojitet tregut të Kosovës. Pastaj, ka të dhëna ku thuhet se, nëse pengohet vjedhja dhe rritet inkasimi i ish energjisë së shpenzuar, konsumi i përgjithshëm mund të bie për 15%. Përsëri shtrohet pyetja - e cilës sasi, do me thënë, të energjisë bie për 15%.

Rritja mesatare vjetore e shpenzimeve të energjisë elektrike është përafërsisht 7%, me këtë shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik. Por unë shpresoj dhe besoj se nevojat për energji elektrike në të ardhmen e afërt do të rriten edhe më shumë dhe kjo është arsye kryesore që të investohet në kapacitete të reja gjeneruese, termike, hidrike dhe kapacitete tjera me burime të ripërtitshme. Objektivat kryesore të kësaj strategjie janë përfshirë në 10 pika, të cilat janë objektiva mjaft të qarta, por shtrohet pyetja sa do të realizohen për një periudhë të caktuar këto objektiva.

Projekti “Kosova e Re”, me kapacitet fillimisht 500 + 500 megavat orë, Hidrocentrali i Zhurit dhe kapacitete tjera më të vogla, me burime të ripërtitshme duhet të ndërtohen sa më parë, sepse qytetarët e Kosovës synim parësor e kanë integrimin në Bashkimin Evropian, ku kjo do të thotë zbatimi i objektivave të planit të Bashkimit Evropian për sektorin e energjisë, që kërkohen nga shtetet anëtare deri në vitin 2020, të përmbushen 3 kushte themelore...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Vazhdojmë. Zoti Tali, regjia na e bën me dije se ka qenë koha e rregullt 5 minuta dhe në fund të mbarimit të transmetimit të seancës. Vazhdojmë me diskutimin, fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

(Driton Tali, reagim nga salla)

NASER RUGOVA: Më falni, koha që po më merret, më kompensohet. Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në seancën e fundit u propozua që një debat i një rëndësie të veçantë nacionale, po flasim për Strategjinë e energjisë, të debatohet dhe të jepen rekomandime dhe konkluzat të nevojshme të nivelit të një institucioni nacional.

Kjo çka po ndodhë sot, me debatin për energjinë, vërtet është shqetësuese, po na shohin edhe qytetarët, edhe miqtë ndërkombëtarë, edhe këshilltarë të transaksioneve dhe atëherë na i marrin asetet me vlerë strategjike, nacionale për 25-40 vjet, 1000 vjet, sepse shohin se sa të papërgjegjshëm dhe çfarë cirkus klase politike ka Kosova. Vërtet, kjo është për të ardhur keq.

Draft-strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2009-2018, apo rishikimi i Strategjisë së energjisë për periudhën 2005-2015. Jemi më 18 mars të vitit 2010, e nderuara zonja ministre, dokumenti i prezantuar është një dokument i vonuar, i cili nuk korrespondon me situatën reale në të cilën gjendet sektori i energjisë në vendin tonë. Kjo strategji është dashur të aprovohet para përsëritjes së procesit për përzgjedhjen e investitorit për ndërtimin e kapaciteteve energjike, siç është emërtuar “Kosova e Re” dhe me kritere të reja.

Këtë dokument tuaj të strategjisë nuk e keni respektuar as ju vet që e keni hartuar apo e ka hartuar dikush tjetër dhe ju keni dalë këtu dhe vetëm e keni prezantuar, siç po shihet, sepse gjatë përsëritjes së procesit i keni ndërruar kushtet pa pasur mbështetje të Parlamentit. Pra, duke anashkaluar Parlamentin, duke vendosur thuajse nuk është mandat i sovranit për të vendosur për tjetërsimin e pasurisë me rëndësi të veçantë nacionale.

Strategjia e energjisë aprovohet për afate kohore 10 vjeçare, me obligim që çdo tri vite të përgatitet programi për implementimin e strategjisë. Programi i parë për implementimin e strategjisë 3 vjeçare është përgatitur për periudhën 2005-2008, në vitin 2008 Kosova është bërë shtet i pavarur. Me çfarë programi është punuar në ndërkohë 2008-2010, zonja ministre? Pra, pa program, me politika të paqëndrueshme, klanore, individuale dhe kjo po shihet haptas.

Sa për ilustrim, strategjia parasheh ndërtimin e termocentraleve të reja, me parashikim që ato të kryhen në vitin 2016. Po atë vit parashikohet të mbyllet “Kosova A” dhe gjithashtu të rehabilitohen njësitë e “Kosovës B”, për t’i përmbushur edhe obligimet ambientale, që është një storie e dhimbshme në vete. Pra, në vend se strategjia të ofrojë zgjidhje të situatës energjetike, ajo e jep të vetmen zgjidhje të problemit - vazhdimin e importit të energjisë, e keni në faqen 43. Në një vend me resurse të tilla, vendi i tretë në Evropë me pasuri dhe rezerva të thengjillit, të përgatitë një strategji që bazohet në rritjen e importit të energjisë, kjo nuk do koment. Dy vite, zonja ministre, është gjysmë

mandati i kësaj Qeverie të pavarësisë, nuk keni qenë në gjendje të identifikoni se cilat janë nevojat energjetike të vendit dhe si të dilet nga kjo krizë e tmerrshme energjetike që e ka kapluar këtë vend me 10.887 kilometra katrorë, që fle mbi pasuri të pazëvendësueshme me thëngjill.

Çështje që duhet të definohen në strategji janë ende të pa qarta për vetë Qeverinë, e lëre më për opinionin e gjerë dhe për deputetët. Duhet të definohet pjesëmarrja e Qeverisë në projekt, duhet të definohet strategjia e shfrytëzimit të thëngjillit, e jo vetëm të ndërrohet emri i minierës, prej Minierës së Sibovcit në Minierën e Re. Në Minierën e Re, do të thotë, Qeveria apo edhe ata këshilltarët e famshëm të këtyre transaksioneve mund të bëjnë çka të donë me pasuri kombëtare. Ky Parlament nuk do të duhej që t'ua merr të drejtën brezave që vijnë të Kosovës, që të tjetërsohet kjo pasuri e një rëndësie strategjike.

Pastaj, në faqe 51, te Energjia elektrike, thuhet se ndërtimi i kapaciteteve gjeneruese prej 1000 megavat, a po e di kush sa megavat brenda këtyre viteve do të gjenerohen, do të ndërtohen në Kosovë, fatkeqësisht askush. Unë mendoj se me këto trende dhe me këtë strategji, pa programe konkrete, edhe për një kohë ne do të mbesim net importues, e do të ishte dashur që bile këto dy vite të fillonim të gjeneronim kapacitete të reja dhe brenda 5 viteve të bëheshim net eksportuesit më të mëdhenj të energjisë elektrike në regjion.

Pastaj, te shthurja e KEK-ut, janë tejkaluar të gjitha ...

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ju faleminderit, Naser! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Nait Hasani.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,
Ministra të nderuar, Pula, Gashi, Jagcilar,
Deputetë të respektuar,

Ja në fillim, po zëmë, strategjia e energjisë. Periudha 2009-2018, a tash jemi në vitin 2010. Kjo nuk shkon, pse strategjia është një dokument i ardhshëm, nuk është historik. Si do ta miratojmë ne strategjinë për një vit më parë. Nuk është në rregull. Ka mundur të përmirësohet kjo punë, nuk është vonë, domethënë neglizhencë elementare e administratës, që nuk është në rregull absolutisht, nuk na bën nder kësisoj.

Referuar politikave dhe rregullimit ekonomik në dokumentin për strategjinë e energjisë, nuk janë të harmonizuara relacionet reciproke ndërmjet institucioneve, MEM-it. ZRE-së, KPMN-së, operatorit të sistemit, më pastaj të KEK-ut, si dhe të ngrohësve. Në qoftë se i marrim dokumentet për themelimin e tyre, do me thënë dalin shumë diskrepanca reciproke. Së andejmi, ndërmjet tyre pashmangshëm do të dalin edhe kolizione më pasoja, ju lutem, të cilat do ta pengojnë seriozisht realizimin e këtij dokumenti, ndryshe të rëndësishëm. Referuar krijimit dhe realizimit të politikave energjetike, një numër i ministrive, Ministria e Mjedisit, ajo e Tregtisë, e Industrisë, e Ekonomisë dhe Financave, konsideroj se do të duhej medoemos të integrohej edhe Ministria e Shëndetësisë, jo edhe, por një ndër ministritë më të rëndësishme në këtë konglomerat të institucioneve tona në funksion të sendërtimit të këtij dokumenti.

Referuar aspektit normativ të strategjisë për energji, duhet vënë në pah se ekziston një numër i madh i akteve ligjore. Mos të flas për ato nënligjore, që nuk janë as komplementare, as nuk janë konsistente reciprokisht. Që, bie fjala, 11 akte ligjore të miratuara, natyrisht, në periudha të ndryshme, nga hartuesit e ndryshëm, që reciprokisht nuk janë në akordancë edhe do të duhej të thuhej, po e zëmë, një obligim edhe me afate, që këto akte do të duhej të rishikoheshin, ju lutem. Do të duhej që medoemos Ministria e Energjisë dhe e Mineraleve të obligohej edhe për funksionin mbikëqyrës administrativ. Ky është funksioni fundamental i ekzekutivit dhe shumë i rëndësishëm, se pa këtë funksion nuk mund të jetë as operative, as funksionale cila do ministri, a sidomos në këtë rast kur është fjala për një dokument të këtillë. Nuk qëndron konstatimi apo konkludimi se ngrohoret e qyteteve, tri janë të tilla, që humbin, lëngojnë nga humbjet për shkak të inkasimit të dobët. Ka shkaqe tjera, ndër të tjera që nuk funksionojnë mirë, se këtu në dokument, na nëse do ta miratonim, do ta miratonim një faktografi inegzistente.

Sa i përket mbrojtjes së mjedisit, që është çështje tepër e rëndësishme, nuk janë ofruar as instrumente, as mekanizma. Ka do përshkrime, do të duhej, madje, madje edhe me disa konstatime historike, ishte kështu, një periudhë, që do të duhej kjo me të vërtetë të ripërpunohej me tepër seriozitet.

Në këtë dokument nuk janë ofruar opsione as zgjidhje komplementare energjetike, nga uji, bie fjala, nga era dhe nga dielli. Edhe, në parim, në qoftë se do të modifikohej, nëse do të ndryshohej e të plotësohej ky dokument, do të kisha votuar me kënaqësi edhe për këtë punë të bërë, kam dëshirë që edhe këtu ta përshëndesim Ministrinë edhe zonjën ministre, Pula. Ju faleminderit për punën e bërë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Nait Hasani, le të përgatitet Sabri Hamiti.

NAIT HASANI: Përshëndetje kryetar!

Përshëndetje ministra!

Kolegë deputetë,

Unë e mbështesë fjalën e Salës, deputetes që e mbajti në emër të Grupit, por unë kam edhe disa çështje për të cilat besoj që 10 vjet kaluan dhe ende ne nuk kemi energji të mjaftueshme.

Më vjen keq që nuk është ministri i Ekonomisë dhe i Financave këtu dhe ai ta ketë parasysh këtë çështje pikërisht, sepse me energji ose për energjinë dhe sistemin e energjisë ne qe 10 vjet vuajmë. Qytetarët e Kosovës edhe me këtë plan strategjik besoj që ndoshta do të dalin nga kjo krizë energjetike, por cilat janë arsyet e energjisë, meqë është ministrja këtu edhe e prezantoi projektin strategjik, kërkoj që të na përgjigjet në pyetjet për çështjen e shkyçjeve kolektive që bëhen vazhdimisht. Cila është arsyeja që çdo qytetari të Kosovës i ndërpritet ose, ta quajmë më ndryshe, është një diskriminim negativ, jo pozitiv, për qytetarët të cilëve iu ndërpritet vazhdimisht energjia. Ata në forma të ndryshme mundohen t'i bëjnë pagesat, por nuk mundën të arrijnë, ndërsa të tjerët që paguajnë, për hir të atyre tjerëve që nuk paguajnë, kemi shkyçje kolektive të të gjitha fshatrave nëpër Kosovë. Mendoj që ne i kemi tejkaluar të gjitha ato, edhe dy vjet pas pavarësisë, pas ndërtimit të shtetit, ne kemi hala këtë neglizhencë dhe të mungesës së energjisë.

Ne me siguri kemi mundësi të blejmë energji edhe të kemi 24 orë qasje në energji, por cilat janë arsyet, kush është ajo firmë apo kompani që e ka projektuar këtë projekt që të

shkyçen të gjitha fshatrat ose fshati komplet për hir X - Y që nuk ka paguar rrymën. Pse unë personalisht të diskriminohem kur unë kam paguar rrymën, e ai tjetri nuk e ka paguar. Pse nuk shkon në shkyçje individuale nëse duhet mbledhur... Besoj se me këtë strategji që e ka hartuar Qeveria, është shumë e gjatë për 10 vjet, ishalla ecën më shpejtë dhe ta realizojmë, që të paktën të fillojmë nga viti i ardhshëm me energji të plotë, se përndryshe kjo është një strategji e mirë, por është afat 10 vjeçar. Kur do të dalim ne nga kriza energjetike, është pyetja për ministren. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, le të përgatitet deputeti Emrush Xhemajli.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar, nuk di sa do të më zgjatë biseda, por jam marrë vesh me Lutfi Hazirin të ma huazojë kohën e vet, në mënyrë që kur t'i kaloj 5 minutat, të mos më ndërpritet fjala. Nuk di a i kaloj, por nëse i kaloj, në marrëveshje me Lutfi Hazirin.

Zoti kryetar i Kuvendit,
Ministra të nderuar,
Zonja ministre e resorit,
Deputetë të dashur,

Unë po e shoh që në bisedën e sotme në Parlament, në të vërtetë kemi dy dokumente, për shqyrtim, dhe një paraqitje të zonjës ministre.

Kemi një dokument që quhet – Strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2009 -2018, kemi një rekomandim të komisionit të kësaj lëmie dhe, në anën tjetër, ne dëgjuam në ekspozenë e ministres edhe ato që quhen - veprime substanciale që i bën Qeveria, të cilat nuk janë në asnjërin dokument prej tyre. Faktikisht, ne tash i kemi tri vija rezonimesh për problemin të cilin e kemi në diskutim përpara.

Duke i pasur parasysh këto dhe duke e dëgjuar edhe ministren sot, unë do të thosha që është mirë që të nisemi nga falënderimi i këtij dokumenti, ku Ministria e merr përsipër dhe falënderon edhe ministratë tjera, edhe grupacionet tjera, edhe të jashtëm edhe të brendshëm, dhe unë pyetje bëj konkrete: Nëse e merr përgjegjësinë Ministria për këtë dokument dhe përmes saj Qeveria, ju lutem shumë, kush është autor dhe ata që ju i quani ekspertë, a kanë emër e mbiemër, sepse për çështje kaq të rëndësishme duhet të jepet emri e mbiemri, titulli, dija e njeriut. Përndryshe, fjala “ekspert” është emër i përgjithshëm dhe mbulon gjithçka edhe nuk thotë kurrëgjë. Pra, kërkoj, nëse është e mundur të thuhet këtu – kush janë ata ekspertë që e kanë hartuar këtë strategji? Kush janë ata të jashtëm dhe të brendshëm, me emër dhe me mbiemër. Unë, tash më lejoni ta them veç një gjë. Unë e shoh që strategjia është një riharnim i një strategjie më të hershme, megjithatë dëshmon edhe diçka tjetër, të cilën unë e hetoj që teksti është vërtet ajo pjesë që është rindërtuar, është rindërtuar në një gjuhë tjetër, mandej del në shqip, për shkak se është e pamundur që njeriu që jeton në Kosovë dhe flet shqip, t'i thotë “ngrohje e përqendruar” ngrohjes qendrore, është përkthim. Do me thënë, janë elemente që tregojnë që teksti është hartuar, së paku pjesët shtesë në një gjuhë tjetër dhe, tani këta përkthyesit tanë, që edhe ashtu nuk e dinë as gjuhën, as lëmin, e kanë përkthyer “e përqendruar”. “E përqendruar”, “e koncentruar” është kuptim totalisht tjetër, lidhje nuk ka me çka pretendohet.

E dyta, Ministria e përmendi një platformë, e përmendi një datë, e mbajta në mend, e shënova, 9 korrik 2009, mandej këtë platformë e lidhi me një datë tjetër rishqyrteuse, 15

korrik 2009. Nëse kjo platformë bëhet referencë për veprimin e Qeverisë, e nga diskutimi i ministres doli që është referencë, nëse është ndonjë kontratë ndërkombëtare me Kosovën, e nga ajo që dëgjuam i bie që është njëfarë kontrate, që është pikë mbështetëse referente, atëherë ju lutem, ne nuk mund ta marrim atë argument këtu në Kuvend dhe ta diskutojmë për pa e pasur këtë tekst, që qenka kaq obligativ, se kontratë, qoftë me ekspertë, qoftë me të cilën do botë përjashta Kosovës. Ajo është dashur të vijë bashkë me këtë platformë. Nuk është dhe unë e kërkoj, këtë e bëj në formë pyetje për ministren ta tregojë cila është ajo platformë, çka shkruan në te, çfarë obligimi është ai. Si të gjitha pikat referente për zhvillimin në Kosovë, mos të mbulohen me miqtë tanë, ekspertët ndërkombëtarë e tjera, se janë emra të përgjithshëm. Ajo që e obligon Qeverinë e Kosovës dhe brezat e këtij vendi, duhet të bëhen dokumente zyrtare dhe të kalojnë nëpër Parlament, të ratifikohen, nëse e kanë gjithë këtë rëndësi.

Tutje, thashë e kemi një platformë dhe e kemi një...

KRYETARI: 5 minutat e Lutfi Hazirit i merr deputeti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Ju faleminderit!

... kjo do të thotë se ne kemi sot një diskutim pak të ngatërruar, në të njëjtën kohë vjen një platformë që do ta marrë bekimin në Kuvend, por në të njëjtën kohë kemi një referim qeveritar, që nuk ka, nuk mbështetet platformë, e tejkalon me veprim, është një veprim konkret. Mirë, le të jetë kjo veprim konkret, por meqë po flasim për kohë të kaluar, edhe projekti i platformës është e vitit të kaluar dhe unë po ju them me gjuhën administrative - nuk janë azhurnuar - thonë, por unë po ju them se nuk kanë hyrë shënimet as të vitit '98 as të vitit '99, brenda në këto analiza që i keni, nuk i keni brenda, do me thënë, është e vonuar. Në të njëjtën kohë aposteriori po flasim edhe për veprimet e Qeverisë. Meqë të dyja janë aposteriori, ne nuk kemi shans të jemi serioz dhe t'i analizojmë këto veprime për pa i bërë publike këtu dhe për pa e marrë pëlqimin në Kuvend, pa i bërë të pëlqyeshme, të pajtueshme njërin me tjetrin. Nëse ne e votojmë platformën, del aut, jashtë veprimi i Qeverisë, se nuk është në platformë, se në platformë e ki atë 1000-shin e famshëm megavat, këndeje po të tingëllojnë dy 500-sha, që në dokumentet zyrtare nuk ekzistojnë. Ato janë në krye të veprimeve s'ekzistojnë në dokument. Po përpiqem të rezymo. Ne nëse duam të jem serioz, kjo platformë kështu sot pa u amendamentuar nuk ka shans të votohet, sepse bëhet konfuzion. Duhet të mblidhen mendimet këtu të vlefshme, të rindërtohen nga komisioni funksional, i ndihmuar, po e zëmë, edhe nga grupet parlamentare, por kur të votohen, të jenë të obligueshme, sepse unë tash e shtroj pyetjen themelore: A e konsiderojmë ne këtë tekst formal a obligativ? Nëse është formal, pro forma, nuk ka problem. Unë nuk i votoj tekstet e tilla, por mund të abstenoj. Por, nëse e konsiderojmë tekst obligativ për zhvillimet strategjike në Kosovë, atëherë ky duhet të zbatohet. Për t'u zbatuar, duhet ta këtë një pëlqim veprimi konkret ditor ose vjetor të Qeverisë me te. Kjo deri tash nuk ka ndodhur, është mospërputhje dhe Kuvendi duhet ta kërkoj këtë, ta bëjë këtu në banka, për ta bërë të besueshëm veprimin e Qeverisë, i cili, keni kujdes, unë nuk dua të flas për veprime partiake, sepse këto janë projekte, edhe me datë thotë deri në 2018. Askush nuk e di cila parti sundon ose udhëheq në Kosovë më 2018. Askush nuk e di këtu, mos të marrim përgjegjësi kohore na këtu, a do të jemi në këto banka? Këto janë strategji përtej një brezi, këto janë strategji për një vend, sepse shpeshherë këtu po bëhemi të ndjeshëm, po i ekzagjerojmë, po i personifikojmë sendet. As ministrija që është në fuqi, atëherë nuk do të jetë, mendoj unë, as ne nuk do të jemi. Ndërsa, marrëdhëniet ndërkombëtare të shteteve i trashëgojnë obligimet. Keni kujdes, mos të marrim obligime

në hunë e buzë, se do t'i trashëgojnë ata që vinë pas nesh. Dhe, në fund, unë nuk jam i lëmisë, por besoni, unë 4 vetë që e njohin mirë këtë lami i kam konsultuar. Katër vetë, të gjithë profesorë, më të mirët njerëz dhe, po ju them, kjo është çudi, sepse kjo është lëmi, (ua jap, ua jap edhe emrat, nuk ka problem, do të habiteni se janë fortë të mëdhenj) është energjetika, është lëmia ku Kosova nuk mungon me kuadro. Nuk po them për elektronikë, për energjetikë. Po ju them, të ashtuquajturit këshilltarë janë amatorë për energjetikë të Kosovës karshi kuadrove të vendit dhe është gabim i madh që edhe kjo strategji nuk është ndërtuar prej tyre. Tjetër është puna e KEK-ut, nuk dua të flas, se është edhe punë e udhëheqjes.

Unë e di që atje ka amatorë që udhëheqin, por ata që dinë, nuk janë aty. Ai është problem tjetër. Problemi themelor është - a do Kosova të prodhojë veç sa të harxhon, a do të prodhojë për treg? Këtu nuk shihet. Ky është vendimi themelor. Ju faleminderit, për të mos m'u ndalë në gjysmë.

KRYETARI: Jo, ke mund të vazhdosh edhe pak. Ju faleminderit! Jo, mjaftë.
Unë, deputet Sabri Hamiti të falënderoj, veç ka qenë mirë diskutimin tënd ta harmonizosh me deputetin që foli në emër të Grupit Parlamentar.

SABRI HAMITI: (Flet pa mikrofon, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Shumë mirë, unë të falënderoj për fjalën që e ke pasur.
Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, le të përgatitet Xhavit Haliti.

EMRUSH XHEMAJLI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë dhe të pranishëm,
Megjithëse në strategjinë për energjinë, me mbi 70 faqe tekst që na është dhënë në dispozicion, nuk jepen përgjigjet e pritshme, të cilat së paku unë i kam pritur aty, nga njëra anë, nga ana tjetër kemi rekomandimet e komisionit.

Partia Socialiste e Kosovës, që e përfaqësoj, në pjesën më të madhe i mbështet rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion të Kuvendit të Kosovës për Strategjinë e energjisë për periudhën 2009 – 2018.

Duke u përpjekur të bëjmë zgjidhje për energjinë shpejt e shpejt, pa kuadër të nevojshëm ligjor, ne në fakt po e bëjmë të kundërtën, po vonohemi më tepër. Andaj, është shumë i nevojshëm Ligji për privatizim, pa të cilin kanë dalë shumë vështirësi të mëdha edhe në lëmin e energjisë, që po e shqyrtojmë sot. Në këto kushte, në radhë të parë mbështesim rekomandimin që Termocentrali “Kosova B” të mbetet pronësi publike, me qëllim të ruajtjes së aseteve të saj dhe njëkohësisht të jetë kundër monopoleve.

Fatkeqësisht, investorët e mëhershëm për “Kosovën e Re” janë tërhequr, mund të tërhiqen edhe të tjerët. Andaj, do të ishte mirë që edhe Termocentrali “Kosova e Re” të ndërtohet nga shteti, me kreditë që do të merrnim nga Banka Botërore dhe FMN. Do të tenderohej vetëm ndërtimi i kapaciteteve të “Kosovës së Re”. Kreditë e mara do t'i kthenim përmes shitjes së energjisë konsumatorëve ose jashtë vendit. Kjo do të ishte edhe alternativë, nëse nuk ka oferta të favorshme nga kompanitë private. Në të kundërtën, nëse ngulet këmbë vetëm në ndërtim përmes privatizimit, qysh po ngulet

këmbë, atëherë do t'iu nënshtrohem kërkesave për ta marr lirë ose për ta falur krejtësisht thëngjillin. Ndërkaq, neve do të na mbetet vetëm hiri.

Strategjia e energjisë për vitin 2008 – 2018, duhet të përfshijë edhe mënyrën e shfrytëzimit racional të linjtit në Kosovë, jo vetëm për energjinë elektrike, por dhe për ngrohje përmes ngrohtoreve qendrore në të gjitha komunat e Kosovës, gjithashtu edhe për mënyrën e përdorimit të mbetjeve të thëngjillit për qëllime tjera industriale. Mendoj se në Strategjinë e energjisë për vitin 2018, është përfshirë ndërtimi dhe mirëmbajtja e kapaciteteve për gjenerimin e energjisë elektrike duke i shfrytëzuar ujërat, pra ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit, të hidrocentraleve të vogla, ku ka mundësi, dhe mirëmbajtjen e dy hidrocentraleve ekzistuese.

Do të ishte mirë që në Strategjinë e energjisë për vitin 2018, t'i kushtohet rëndësi prodhimit të energjisë elektrike me erë, që në fakt aty përmendet vetëm pak ose fare. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti, le të përgatitet deputeti Gani Geci.

XHAVIT HALITI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar Kabinet i Qeverisë,

Deputetë,

Unë, pa dashur që të thellohem në problematikën e strategjisë dhe të qëndrimeve të komisionit, jam i prirë që t'i ngrejë dy çështje, me të cilat besoj që shumica këtu jemi dakord, që Kosova ka nevojë për prodhim të energjisë, që Kosova për t'i hapur perspektivë vetes dhe investimeve të huaja në vend, duhet të ketë energji të mjaftueshme për kapacitetet ekonomike që mund të ngrihen në Kosovë dhe jo të llogarisim vetëm në përmbushjen e nevojave të sotme të cilat i ka Kosova, që janë të shumta dhe të pa përmbushura.

Si çështje tjetër, ne e dimë shumica këtu që mafia e tregtisë me energji elektrike është shumë e fuqishme, jo vetëm në rajon, por në vazhdimësi besoj që do të përpiqen që të fusin pyka në mundësinë e kapaciteteve tona për t'i zhvilluar ato. Arsyet dihen, sepse ata donë ta shesin energjinë elektrike dhe nuk kanë interes, me një fjalë, që ne të prodhojmë. Prandaj, cilido qoftë epilogu i votimit të strategjisë, ne duhet të jemi të bindur që pa energji elektrike, pa pasur energjinë tonë elektrike, ne nuk mundemi të zhvillojmë kapacitetet, po them, industriale të ardhshme të Kosovës dhe përmes tyre të sigurojmë edhe vendet e punës për qytetarët tanë, të cilët dihet se në çfarë gjendje janë.

Një çështje tjetër që mua më intereson shumë dhe do ta ngrejë, do të mbështeten në propagandën që e zhvillojnë në vitet '70, kur ne i ngrehnim çështjet pse nuk po hiqet hiri i termoelektranave të Kosovës dhe ka qenë një propagandë që hiri ka një kosto shumë të lartë dhe vendet e veçanta të Bashkimit Evropian janë shumë të interesuara ta blejnë hirin, por ne nuk po duam ta shesim, sepse gjëja hiri po u shitka, po e kërkojnë me çmim të vogël. Unë kam një pyetje në këtë çështje, cilat do qofshin kapacitetet tona të mundshme të prodhimit të energjisë elektrike, për hir të asaj që ambienti dhe hiri kontaminon tokën, helmon ajrin, dua ta dijë se çfarë do të bëhet me hirin që prodhohet nga qymyri ose nga linjiti i Kosovës. Besoj që nëse ne publikisht debatojmë për këto çështje dhe për çështje tjera, të cilat disa nga parafolësit i theksuan shumë mirë, në veçanti do të thosha ngritja e çështjes që e bëri profesor Hamiti lidhur me atë

ekspertizën e mundshme, e cila kërkon një debat edhe më të madh publik, do të thosha, është e domosdoshme që të informohemi jo vetëm ne, por të informohet edhe qytetari i Kosovës, me qëllim që vendimet ose votimi që do t'ia bëjmë strategjisë dhe nesër dhënien me koncesion ose marrjen së kredive ose ndërtimin e këtyre kapaciteteve, të jemi të lirë që me gjeneratat e ardhshme të mos kemi obligime, me një fjalë, në raport me ta dhe të mos biem në pozitat e kalimit ose të debatit të radhës, të miratimit të strategjisë së radhës, me qëllim që ta ndryshojmë këtë strategji radhën tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Geci, le të përgatitet deputeti Bajram Kosumi.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Në rend të parë, unë dua të ndërlidhem me veten time që nuk marrë farë ere në strategji të energjisë, por ato që i shohin të gjithë qytetarët dhe ne si deputetë, janë disa çështje.

Më e rëndësishmja është që Republika e Serbisë, apo Korporata e Energjisë së Serbisë operon në territorin e Kosovës dhe në pjesën veriore të Kosovës dhe në këtë strategji nuk ka asnjë fjalë se si duhet të ndalen këto operime në territorin tonë.

Tjetër çështje me rëndësi është se ne si deputetë, juristët, gjuhëtarët edhe historianët s'marrin vesh në energji dhe Qeveria e Republikës së Kosovës edhe Ministria nuk ka angazhuar ekspertë të posaçëm. Vendet përreth kanë angazhuar ekspertë nga Sllovenia për hartimin e strategjive të tyre, ndërsa ne, këshilltarët që i kanë ministritë, i kanë për rroga më tepër se sa për ekspertë. Këtë e dinë të gjithë qytetarët.

Një çështje tjetër mjaft me rëndësi që flitet në strategji, është periudha 2009-2018, apo periudha dhjetëvjeçare. Dy vjet janë bërë deri sa ka ardhur ky dokument, është edhe dokument i rishikuar për periudhën 2005-2015, do të thotë, ka disa ndryshime dhe dy vjet kanë shkuar për ta prurë këtë dokument qysh është, dhe sa vjet do të shkojnë që ky të implementohet në praktikë? Në këtë dokument ne jemi më tepër të informuar rreth punës së Ministrisë, rreth punës së Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, se sa rreth ndonjë strategjie të mirëfilltë. Gjithashtu, në këtë strategji flitet edhe për periudhën 2005-2008. Ne e dimë se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ky Parlament ka alokuar mjete miliona euro për Korporatën Energjetike të Kosovës dhe ato miliona euro kanë shkuar në tenderët e kësaj korporate për të hequr dhe nga një vend dhe për ta qitur në një vend tjetër, ose për ta prurë nga ai vend prapë në vendin ku ka ndodhur. Dhe, kjo ka qenë një punë që është bërë për këto vitet e pasluftës dhe disa kompani private, që kanë qenë të afërta me ministritë e atëhershme dhe të tashme, janë pasuruar në këtë drejtim.

Gjithashtu në këtë strategji nuk flitet aq tepër rreth ndotjes së ambientit. Të nderuar qytetarë, ju e dini se Qeveria e Republikës së Kosovës, po edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, në kohët e fundit janë të sëmurë nga kanceri, kjo sëmundje që ne nuk po e dimë se nga po na vjen. Në bazë të këtyre rezultateve del se KEK-u më tepër prodhon sëmundje se sa energji elektrike, më tepër harxhojmë mjete për të shkuar për t'u shëruar në vendet perëndimore nga kanceri, që prodhohet, ndoshta, po them, nga KEK-u se sa që ne prodhojmë energji dhe pa energji dihet që nuk ka jetë. Dhe, duke pasur parasysh këto, del se Korporata Energjetike e Kosovës, në njëfarë forme në bazë të dhënave është me një kapacitet të ulët dhe me një teknologji mjaft të vjetruar,

teknologji e cila nuk përkon me realitetet që do të vijnë për vitin 2009-2018. Por, strategjia që na është ofruar këtu edhe për mua që nuk marr asgjë vesh në këtë lëmi, s'kam lidhje në këtë, është e kuptueshme që është një strategji për t' i mbushur xhepat dikush nga Qeveria kur të shiten asetet. Nëse në këtë strategji që është ofruar shteti i Kosovës nuk ka mbi 51% të aseteve, do të kemi probleme sociale. Ne ashtu, kështu po kemi probleme, punëtorët e KEK-ut dhe ministrija e di, se ata po kërkojnë rroga më të larta dhe tash kur dikush ta privatizojë 85% ose 80% ose 75%, pjesën dërrmuese të punëtorëve do ta largojë nga vendet e tyre të punës, sepse nuk i nevojiten më dhe do të kemi probleme tjera sociale.

Gjithashtu në dokumentin e strategjisë thuhet se kemi pasur përkrahje nga donacionet e donatorëve në Bruksel. Nuk ceket asnjë shumë, nuk ceket asnjë program se cilat shuma kanë qenë si përkrahje ose janë të përcaktuara si përkrahje

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, le të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Qeveria dhe propozuesi i strategjisë nuk ka sjellë argumente pse “Kosova B” si një prej ndërmarrjeve më profitabile të Kosovës, duhet të jetë pjesë e pakos tenderuese për “Kosovën e re”? Unë do ta përkrahja strategjinë, me kusht që paraprakisht të votohet për propozimin e Komisionit, propozimin e parë të cilin e parasheh ndryshe, që “Kosova B”, të mos jetë pjesë e pakos tenderuese. E them këtë për arsye se vetëm “Kosova B”, pavarësisht prej nevojave të mëdha të konsumit të energjisë elektrike në Kosovë, mund të quhet madje ndërmarrja më profitabile në Kosovë. Dhe, pse do të duhej ndërmarrjen më profitabile në Kosovë ta fusim si koncesion për një ndërmarrje të re e cila ende nuk i dihet fillimi saktë? Madje këtu kjo çështje lidhet me vizionin e Qeverisë, nuk është çështje vetëm e një strategjie. Qeveria asnjëherë nuk e ka shpjeguar pse po ngutet të privatizojë Aeroportin, pse po ngutet të privatizojë PTK-n. Është gabim që resurset jetike të vendit tonë të privatizohen shpejt e shpejt, pa e krijuar infrastrukturën e duhur, madje edhe po ta kenë infrastrukturën e duhur, do të duhej të debatohej gjerësisht- a duhet të privatizohen resurset jetike të Kosovës? Po të arrinte Kosova të bënte njëmijë megavatëshin, Kosova do të shndërrohet në faktor ekonomik, ndërsa e dimë shumë mirë që ai që është faktor ekonomik është edhe faktor politik. Zvarritja e njëmijë megavatëshit, humbja e hapit në krijimin e njëmijë megavatëshit, de fakto është zvarritje e faktorizimit politik të Kosovës, këto janë pasojat. Pastaj është një kundërthënie tjetër. Nëse kriza ekonomike globale, që unë e marr pak me rezervë, nëse kriza ekonomike globale ka ndikuar që të mos ketë para për “Kosovën e re”, për njëmijë megavatëshin, atëherë qysh paska para për ta blerë, pra Aeroportin. Qysh ka para për ta blerë PTK-n, pra? Këtu është një kundërthënie, nëse nuk ka para për “Kosovën e re”, atëherë s'do të duhej de fakto të kishte para as për Aeroportin, por nëse ka para që të blihet Aeroporti, atëherë do të duhej të kishte para edhe për “Kosovën e re”. Mendoj se kjo është një politikë ad-hoc, një politikë pa vizion e cila mund ta dëmtojë interesin jetik të Kosovës. Nuk është kurrfarë argumenti që privatizimi i ndërmarrjeve publike të bëhet për ta luftuar korrupsionin, sepse nëse privatizohen ndërmarrjet publike s'do të ketë klasa politike qysh të korruptohet.

Korrupsioni luftohet ndryshe. Nuk mund të rrezikojmë interesat ekonomike të Kosovës, thjesht, nën argumentin për ta luftuar korrupsionin.

Çështja e dytë që dua ta ngre tash është çështja përsëri lidhet me koncesionin për minierën e re. Në strategji thuhet një fjali, mund të them shumë e pa përkufizuar. Thuhet “një pjesë e minierës së re duhet të jetë pjesë e pakos tenderuese ose mund të jetë ose të mos jetë tërë miniera e re”. Unë mendoj se kjo fjali duhet të hiqet prej strategjisë dhe të lihet që një pjesë e minierës së re të jetë koncesion i Qeverisë së Kosovës për termocentralin “Kosova e re”. Do të thotë, Qeveria e Kosovës të ketë koncesione në termocentralin “Kosova e re”, por përmes minierës, ose një pjese të minierës dhe jo përmes “Kosovës B”.

Dhe, në fund, më lejoni të propozoj që kjo strategji të votohet pasi të harmonizohet me Komisionin, me propozimet e Komisionit dhe me propozimet që dolën gjatë seancës sot, me veçanti e theksoj diskutimin e zotit Hamiti, që të formohet një grup i punës, të harmonizojë strategjinë me propozimet dhe pastaj në seancën tjetër ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, le të përgatitet deputeti Enis Kervan.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Është e qartë që shtetet që kanë standardin më të lartë të zhvillimit t’i kushtojnë rëndësi shumë të veçantë kësaj fushe. Tek ne dhe këtu siç duket, duke filluar jo vetëm nga Qeveria, por edhe nga Kuvendi i Kosovës, pothuaj se e neglizhojmë këtë çështje duke marrë parasysh se pikësëpari kjo strategji ka ardhur qysh në shtator, ndërsa vetëm pas 5-6 muajve arrihet nga Kryesia të futet të futet në rend dite dhe po ashtu edhe nga Komisioni funksional që është shqyrtuar vetëm pas 3 muajve. Kjo është vërejtja e parë, që reflekton edhe sot në këtë debat, i cili më shumë duket se është karakter politik se sa në atë që jepet profesional dhe çka ne do të arrijmë dhe çka do të bëjmë? Pasi që të gjithë e quajmë çështje kombëtare dhe unë mendoj që të gjithë këtu së paku thirrëmi në kombëtare dhe kurrkush nuk është kundër interesit nacional.

Si përfundim, për të mos e zgjatur shumë, me të vërtetë edhe nga debatet të cilat mund të kontribuojnë, por janë disa çështje që tash janë ngatërruar apo për mua plotësisht janë ngatërruar edhe nga dokumenti i paraqitur, por edhe nga ato çka më herët ne kemi dëgjuar, duke filluar që nga kapaciteti i ndryshimit 1000 plus 1000 në 500 – 500 dhe te çështjet tjera te ai fjalori “mundësisht” ose “mund” ose “mund të mos jetë”, sepse në këto çështje nuk mund të kemi “mundësisht”. Nëse ka pasur studim të qartë ose të mirëfilltë nuk mund të quhemi “mundësisht të ndërtohet këtu Kosova e re apo t’i ndërrohet lokacioni”.

E vetmja ajo që unë pajtohem është se së paku figurativisht paraqitet mirë, nëse ndërtohet kështu e në këtë formë, ndërsa a duhet të harmonizohen këto qëndrime, dhe jo që duhet po patjetër duhet të harmonizohen për të ardhur te një përfundim apo në fund për ta mbyllur këtë diskutim rreth kësaj strategjie, sepse e pamë që është ndërruar 2005-2015, 2009-2018 dhe mos të dalim që çdoherë ose brenda vitit 2009, që tash po na paraqiten disa propozime të tjera? Po të lexohet edhe në raportin e punës së Qeverisë për vitin

2009, jepen disa konkluzione tjera, ndërsa tash ka ndërruar, në bashkëpunim që përmenden edhe Banka Botërore dhe akterët tjerë që ndihmojnë, që për mua, me të vërtetë paraqesin mospërputhshmëri të madhe në ato çka duam ne të arrijmë. Faleminderit, zoti kryetar! Kaq pata!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Enis Kervan, le të përgatitet deputeti Ardian Gjini.

ENIS KERVAN: Bu evrak aslında, Kosovada belli bir döneme yönelik Enerji Stratejisinin incelenmesinin gereğini ortaya koymaktadır. Güncel durumu inceleyerek, yapılan çalışma ve tepkilere dayanarak edinilen bilgiler değerlendirilirken bu strateji, enerji sektörünün karşılaşmakta olduğu eylem alanında önemli sınavını belirlemektedir. Kosova için yaşamsal önem taşıyan bu çok önemli sektörün, Kosova tüketicileri için ekonomik açıdan en elverişli ve verimli enerji hizmetlerini sunabilmesine yönelik, kalıcı ve kendini finanse edebilecek bir sektöre acilen dönüştürülmesi doğrultusundaki eleverişli politikaları yönlendirmek, çevrenin korunması ve Kosova enerji sisteminin, yöre ve Avrupa enerji sistemine tamamıyla ve kısa zamanda entegre olmasını sağlamak amacıyla, bu sektördeki reformları körüklemek için alınacak önlemler belirlemelidir.

10 yıllık bu stratejinin amacı, enerji sistemimize özel kesim yatırımcılarını celbedecek tam anlamıyla yasal ve düzenleme çerçevesinin hazırlanmasını sağlamalıdır. Bu düzenleme çerçevesi, yabancı yatırımcıların güvenini kazandırmak adına ayan ve net bir şekilde olmalıdır. Bundan başka bu düzenleme çerçevesinin sıkı ve tedbirli bir şekilde uygulanması, dolayısıyla önlemlere saygı gösterilmemesi durumunda, kamu veya özel kesim katılımcılarına yönelik önlemlerin mahkeme destekli olarak değiştirilmesini mümkün kılan bir uygulama niteliğine sahip olmalıdır.

Vatandaşların elektrik yokluğu yüzünden, haksız olarak elektrik kesintisine maruz kılışını önlemeyi ve çözüm üretmeyi de gözönünde bulundurarak, Kosova B Termosantralinin, Kosova e Re Termosantral özeleştirilmesi kapsamına alınmamasını ve Kosova e Re- nin olanaklar dahilinde, Kosova A dolayında inşa edilmesi gibi, Meclis komisyon tutumlarına da destek sunduğumu ve 2009- 2018 dönemine ait enerji stratejisini kabul ettiğimi bir daha belirtmek istiyorum. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, le të përgatitet deputeti Berat Luzha.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Para se të kaloj saktë në temë, mendoj se duhet për ta shënuar një çështje. Deputeti Driton Tali është ankuar se iu ka këputur fjala më herët, kërkoj nga ju që të kërkonit nga sekretaria që të shihet xhirimi dhe të verifikohet dhe se nëse ka ndodhur diçka e tillë, është shkelje tepër e rëndë në Kuvendin e Kosovës dhe më duhet të them se nuk ka ndodhur për herë të parë. Kështu që është kërkesë zyrtare që të verifikohet për shkak se, edhe një herë po them, që t' i këputët deputetit fjala para kohës prej regjisë, pa fjalë të kryetarit ose të kryesuesit, është një ndër shkeljet më të rënda që mund të ndodhë në

Kuvend dhe nuk është hera e parë, kemi pasur raste edhe më përpara, na ka ndodhur e njëjta gjë.

Tani po kaloj në temë, në të cilën jemi. Çështja e parë për të cilën kisha folur unë është serioziteti. Serioziteti në punë, të gjithë po themi se është një ndër dokumentet më serioze, një ndër dokumentet më të rëndësishme të cilat i kemi marrë dhe të cilat Kuvendi duhet t'i aprovojë dhe janë dy elemente të cilat më bëjnë për të dyshuar që Qeveria vetë e ka marrë me seriozitet këtë dokument.

Çështja e parë është se kur Kosova flet për energjinë, është sikur të flas një eksportues i madh i naftës për naftën, kështu që ndër temat më të rëndësishme dhe ma merr mendja që në çdo vend serioz, të gjithë deputetët dhe të gjithë ministrat ishin bërë rresht për një të jenë në sallë kur diskutohet strategjia e energjisë. Sot e kemi vetëm ministren e Energjisë, që s'ka zgjidhje përpos që të jetë këtu dhe mezi që i kemi 61 deputetë. Dhe, realisht, shumica e atyre që mungojnë janë prej vetë partive në pushtet. Kjo është pjesa e parë e seriozitetit, me të cilin merremi ne në këtë strategji.

Pjesa e dytë e seriozitetit është vetë dokumenti. Nëse një qeveri punon një dokument kaq të rëndësishëm, disa muaj, të mos themi një vit, atëherë arrijmë ose të paktën të them kështu më saktë duhet për të arritur ta shohim edhe gjuhën e dokumentit. Domethënë, nëse e shihni Kushtetutën e vendit, për shembull, nuk ka gabime se e kanë marrë seriozisht ata që e kanë bërë atë punë, një dokument tjetër, lidhet mirë, ndërtohet asisoj që vetë dokumenti të tregoj sa serioze është Qeveria për atë çështje për të cilën flasin. Nëse e merrni këtë dokument që e kemi ne sot, nuk ta lë përshtypjen se dikush seriozisht është marrë me të. Është një dokument që të bën të dyshosh që vetë Qeveria ka për t'iu përmbajtur çka ka shkruar në të për shkak se nuk reflekton me kurrfarë serioziteti dhe ne tash duhet ditur a thua po bëhet kjo strategji për ta përmbushur një obligim ligjor e ndërkohë për të vazhduar me një strategji që nuk është në letër, por që është krejt tjetër, që e përmendën disa deputetë këtu, të mos i përsëris.

Çështja tjetër për të cilën dua të flas shumë shkurt, është se kjo Qeveri është ndërtuar ose ka fituar zgjedhjet në vitin 2007, me dy premtime: 24 orë rrymë dhe luftë kundër korrupsionit. Mendoni vetë se sa i ka përmbushur premtimet e veta.

Çështja tjetër është se populli i Kosovës ka jetuar me shpresën se një ditë do të jetojë më mirë, shumë më mirë për shkak të pasurive tona natyrore që i kemi. Domethënë, me këtë temp dhe me këto ide që i kemi ne sot, populli i Kosovës duhet prituri një milion vjet derisa të bëhet qymyri naftë dhe të fillojë të zhvillohet dhe t' i gëzojë pasuritë e veta për të cilat ka shpresuar se një ditë kanë për të na nxjerr në dritë. Kur kemi folur për pavarësinë para 20 vjetëve kemi thënë se kemi pasuri natyrore, kemi resurse të mjaftueshme, do të mund ta mbajmë veten. Shihni se çka ndodh tash!

Dhe unë dua të pyes – a i kemi dikujt borxh ne si Kosovë? Dhe, nëse i kemi borxh duhet ta dimë për të debatuar dhe ne i lajmë borxhet, nuk mbesim pa i larë borxhet. Po pse po bëhet kështu? Pse kanë kaluar 2 vjet e gjysmë dhe ne nuk e kemi hala idenë e saktë se çka po duam të bëjmë, kur projekti ka qenë gati para përfundimit. Ehe, është e saktë, tha një deputet para meje – fuqia energjetike të shndërron në fuqi politike, realisht. Dhe, ne i kemi humbur 2 vjet e gjysmë duke mos bërë asgjë.

Çështja tjetër është, disa pyetje, realisht, në fund të fundit. Sikur strategjia Antikorrupsion, edhe kjo strategji po na vjen vonë, teknikisht vonë. Strategjia është 2009

– 2018, që do të thotë nëse është strategji dhjetëvjeçare duhet të përfshihet viti 2009 në implementim të strategjisë që të jetë dhjetëvjeçare, përndryshe është nëntëvjeçare, nëse nuk përfshihet viti 2009. Nëse viti 2009 përfshihet, atëherë jemi vonë ne, në implementim të strategjisë, se nuk po flasim për 100 vjet, por për 10 vjet dhe nëse në 10 vjet, je vonë 6 muaj, 5% e kohës së implementimit ka shkuar huq. Dhe, 5% e kohës së implementimit është goxha gjatë.

Çështja tjetër është...

KRYETARI: Mund t'ia vazhdoni fjalën deputetit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Çështja tjetër është se në ekspozë, realisht, ministrja ka titull akademik dhe me siguri është format. Kur duam të ndërtojmë strategji, ndërtojmë për të kaluar prej një gjendje një gjendje tjetër. Dhe, realisht, në ekspozë duhet të vijë e të na thuhet: gjendja sot është kështu dhe të shpjegohet gjendja çfarë gjendje kemi, sepse, duke shpjeguar gjendjen i shpjegon arsyet pse duhet pasur strategji për të kaluar një gjendje tjetër? Domethënë, bëhet një hyrje. Ne nuk e kemi ndie këtë çështje. Dhe, në fund të fundit, pa hyrë në materie, të paktën në ekspozë duhet të na thuhet qysh ka për t' u dukur Kosova në aspektin energjetik kur të implementohet strategjia, domethënë, çka ndodh? Nuk mund të ndërtohet strategjia e mos vijë e ta na thotë dikush që strategjia, që çka kemi për të bërë. Po çka ndodhë? Qysh duket Kosova në momentin që strategjia, shembull ta marrim – për shembull: implementohet plotësisht? Këtu s'ka për t'u implementuar, nuk e kemi dëgjuar këtë çështje.

Çështje tjetër është se në ekspozën e vet ministrja më shpesh ka folur për energjinë alternative, për mjedisin, për krejt – e ne jemi në ferr, a këto janë krejt të rëndësishme. Absolutisht të rëndësishme, të pa anashkaluar në çfarëdo strategjie energjetike. Po mendoj se kur fillon fjala duhet të fillojë – duam të prodhojmë energji dhe të ikim prej territorit, atëherë të flasim për aspekte tjera se sot ne kemi problem me energji.

Çështja tjetër është se nuk e shohim këtu ministrin e Punës, shembull të marrim. Të gjithë e dimë, edhe ne edhe njerëzit të cilët na përcjellin se, shembull ta marrim papunësia në Kosovë është tepër e madhe dhe është duke u rritur, po rritet papunësia. Pse rritet papunësia, për shkak se e kemi natalitetin më të madhin në Evropë dhe zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës nuk e përcjell rritjen e popullsisë, që do të thotë përqindja e njerëzve të papunë në Kosovë shkon duke u rritur. Dhe, është përmendur këtu, më herët, prej vetë njerëzve të Qeverisë dhe është përmendur edhe prej tjerëve dhe prej nesh që një rritje përmbi 6% në vit, kishte për të garantuar që në përqindje nuk rritet papunësia. Dhe, vetëm për t' i absorbuar njerëzit e rinj që hyjnë në treg të punës për çdo vit dhe ta mbajmë njëjtë përqindjen, na vyen një rritje prej 6%. Tani qysh të garantojmë ne rritjen prej 6%, të paktën edhe 4 a 5 vjet që vijë, pa energji. Dhe, do të thotë, dikush duhet të mendojë qysh duam ne ta zgjidhim këtë problem në Kosovë me këto farë strategji, me këto far politika dhe deri kur do të vazhdojë të rritet papunësia që një moment të fillojë të bie? Edhe kjo duhet të jetë pjesë e strategjisë së energjisë se ne e kemi burimin më të madh ekonomik, s'kemi tjetër, në fund të fundit.

Çështje tjetër, për ta përmbyll me këtë fjalë timen, është se çka duam të bëjmë deri në vitin 2016, realisht? Strategjia duhet ta parashohë gjithçka çka duam të bëjmë deri në vitin 2016, se nuk kemi energji dhe nëse sot në PIK na duhen 1.200 megavat, kur do të

kemi mjaftueshëm vetëm sa për veti? Do të thotë pa industri. Edhe një herë po përsëris, sot në Pik na duhen 1.200 megavat, pa industri, pa punësim – pa u punësuar njerëzit që po presin për t'u punësuar se ata kur të punësohen me energji punojnë në ato uzina, fabrika e çka do që janë dhe plus me këtë rritje të popullsisë, me rritjen e numrit të amvisërive, të shtëpive – a ka për ta mbuluar kjo çka shkruhet në këtë strategji, a e mbulojnë këto kapacitete vetë nevojën e Kosovës? Dhe, prapë, shikoni jemi duke folur që 5 vjet, as nuk e kemi nisur këtë. Do të thotë që 5 vjet jemi duke folur dhe 5 tjera kanë për të shkuar – shkojnë 10, e ne jemi duke folur për një strategji dhjetëvjeçare dhe në momentin që fillojmë ta implementojmë duhet të fillojë të mendojë çka të bëjmë kur të kryhet se nuk kemi mjaftueshëm.

Mendoj se kjo strategji nuk i jep përgjigje këtyre pyetjeve. Nuk është serioze dhe më bën të dyshoj se Qeveria ka strategji të veten, po jo kjo që është këtu. E ka ndonjë ide të veten se çka të bëjë, qysh t' i joshë investitorët, qysh t' i fillojmë kapacitetet dhe duhet kërkuar që nëse e voton Kuvendi strategjinë, se njëherë e ka pas votuar, por nuk është implementuar, nëse Kuvendi e voton atëherë, të paktën kërkojë çka ndodhur rreth “Kosovës së re”, apo “Kosovës C”, qysh doni quani, duhet të jetë në përputhje me strategjinë që e voton Kuvendi, të paktën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Një sqarim për kërkesën. Deputeti Driton Tali ka folur më shumë se 4 minuta, po nuk ka folur 5 minuta. Diku rreth 1 minutë i është ndërprerë gabimisht fjala, nga regjia. Po, që e pranua. Ju e kërkuat, unë e dhashë sqarimin. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha dhe jam i mendimit që pastaj të shkojmë në një pauzë.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Strategjia energjetike e Qeverisë, por edhe debati i sotëm po i kushtohet plotësisht ndërtimit të kapaciteteve të reja termike, energjetike, përkatësisht të “Kosovës së re”. Qeveria ka bërë mirë që e ka reduktuar projektin për ndërtimin e kapaciteteve prej 2.100 megavat orë, me ndërtimin e termocentraleve të reja prej njëmijë megavat, 2 herë nga 500, si dhe me ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit dhe të mini-centraleve, do të përmbusheshin nevojat energjetike të Kosovës për një kohë të gjatë. Kosova duhet të orientohet edhe kah ndërtimi i hidrocentraleve të vogla nga uji me kapacitete nga 1 deri 15 megavat. Këso hidrocentralesh mund të ndërtohen nëpër rrjedhat ujore të cilat janë të shumta.

Nuk e di se çka u bë me fatin e 2 hidrocentraleve të vogla që ishin planifikuar të ndërtoheshin në lumin Lepenc? E dimë se ishte prerë shiriti për ndërtimin e tyre, por që dy vjet ato ende nuk kanë filluar të ndërtohen.

Nuk e dimë, gjithashtu, si qëndron puna edhe me hidrocentralet e Dikansit, Deçanit, Radavcit e të tjerë?

Në komunën e Vitisë ka një projekt për një hidrocentral të vogël, me të cilin parashihet edhe ujitja e mijëra hektarëve të tokës dhe sigurimi i ujit të pijes për mbi 100.000 banorë.

Një çështje tjetër në strategjinë energjetike do të ishte edhe prodhimi i energjisë nga era, nga dielli, bioenergja e tjerë. Është koha kur, si në tërë botën, të fillojmë edhe me këtë lloj të energjisë.

Meqenëse termocentralet kanë ndikim të madh në mjedis, duke prekur peizazhin e natyrës, ndotjen e ajrit, të ujërave e të tokës, krijimin e zhurmës e tjerë, atëherë duhet pasur shumë kujdes kur planifikojmë ndërtimin e kapaciteteve të mëdha termike, energjetike.

Gjendja mjedisore në komunën e Kastriotit edhe sot është, mund të thuhet, katastrofike, të theksojmë se jeta e banorëve në një pjesë të madhe të kësaj komune është vështirësuar tepër shumë, sa është bërë edhe e rrezikshme për shëndetin dhe për jetën e njeriut. Të theksojmë se mbi 70% të tërë territorit të kësaj komune është shpallur si zonë e interesit të veçantë.

Ndërtimi i kapaciteteve të reja termike sa do moderne të jetë teknologjia e tyre, do të ketë ndikim edhe më të madh mjedisor, në një mjedis edhe ashtu të ndotur jashtë çdo mase.

Është e domosdoshme që Qeveria, përkatësisht Ministria e Mjedisit dhe ajo e Energjetikës, bashkë me KEK-n dhe komunën, e mbështetur edhe nga donatorët e jashtëm, paraprakisht të bëjë një projekt për rehabilitimin e mjedisit në këtë komunë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pauzë deri në orën 14,30. Pra, i lus grupet parlamentare që t'i ftojnë deputetët të vijnë, sepse duhet të marrim vendim në fund. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, luteni që t'i zëni vendet dhe të vazhdojmë me seancën. Fjala i jepet, për 2 minuta deputetit Driton Tali. 1 plus 1, një që e meriton dhe një që kemi gabuar ne.

DRITON TALI: Faleminderit! Faleminderit, që megjithatë e pranuat gabimin. Sidoqoftë, atë që e thashë, është se strategjia që në fillim nuk është e shkruar në mënyrë serioze, andaj edhe nuk duhet marrë shumë seriozisht.

Ajo që të bie në sy, është ngase ... e ministrit të Ambientit, korrekt, ngjashëm ka qenë edhe në raportin e AKP-së, nëse ju kujtohet, njëherë na kanë pas sjellë një raport në fleta të thjeshta, i dhamë të gjitha ato kritika dhe, në fund, pastaj asnjë kritikë nuk është marrë. I njëjtin material është, vetëm se na e kanë sjellë në glos-letër të trashë. Për këtë arsye, unë thashë se pa marrë parasysh çfarë kritikash japim, është e kotë, sepse Qeveria veç e ka marrë vendimin dhe do të bëjë ashtu siç i teket asaj.

Tash, pa dashur të futem në këto sfot-analizat, që kam përshtypjen se këto sfot-analizat është që vetëm se një njeri që shkruan, se është stili i tij dhe ai besoj se është në vit të parë diku në fakultet duke studiuar, se është stili i brucoshave. Po them, ta lexosh këtë, bien në atë çka thuhet ajo thënia se “prej çkahit i mençuri marrohet, i marri krenohet”

Por, të kthehem në një pikë pak më serioze nëse kam vakt. Sipas kësaj strategjie, faqe 11, shihet se Kosova mund të gjenerojë nga blloqet A, A 3 - 115 megavat, A 4 – 115 megavat, A5 gjithmonë 115 megavat, e tjera, domethënë, totali është 355 megavat dhe B-ja mund të prodhojë në dy blloqe 520 megavat....

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuara ministre, i nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Sektori i energjisë, pa mëdyshje është me interes jetik për shtetin e Kosovës, për zhvillimin e tij ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve të Kosovës. Prandaj, qeverisja e mirë e këtij sektori është e rëndësishme jo vetëm për ne, por edhe për gjeneratat e ardhshme. Dokumenti i strategjisë së energjisë për periudhën dhjetëvjeçare 2009-2018 duhet trajtuar seriozisht. E para që është dashur të bëhet, është që ky dokument duhet të jetë në harmoni me strategjinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, të cilën strategji Qeveria e Kosovës nuk e ka hartuar ende.

Një mungesë tjetër e kësaj strategjie është formimi i një kornize e cila do të përmbante politikat e qarta, masat dhe objektivat të cilat do t'i përgjigjeshin realitetit. Çka do të thotë kjo? Ne kemi një shpërputhje në mes të asaj çka kemi dhe jetës e cila zhvillohet në Kosovë. Në vetë dokumentin, thuhet: “Rezervat gjeologjike të linjtit janë vlerësuar të jenë rreth 12.5 miliardë ton.” Nëse është kështu, ashtu siç e tha edhe kolegu Çeku, jemi vendi i pestë nga rezervat e linjtit. Nga ana tjetër, ne kemi shpenzuar 2 vjetët e fundit 150 milionë euro për importimin e energjisë dhe çmimet e energjisë janë të larta, kurse popullata është e varfër, prandaj kjo është mangësi e kësaj strategjie.

Tjetra është se dokumenti duhet të jetë një akt balancues në mes përfshirjes së shtetit dhe të privatizimit, çka do të thotë nuk duhet të jetë pjesë e pakos tenderuese “Kosova B”, për shkak se cilido që e merr këtë termocentralin “Kosova B”, do të mundohet që të fitojë sa më shumë që është e mundur për t'i kthyer investimet e veta dhe kjo do të shkojë në kurriz të konsumatorëve, sepse do të rriten çmimet e rrymës.

Të nderuar deputetë,

Pjesa më e madhe e strategjisë ka të bëjë me vlerësimin se si është sektori i energjisë në periudhat e mëparshme deri në ditën e sotme? Nëse është kështu, zonja Ministre, unë kisha propozuar që ju të bëni vlerësimin dhe krahasimin në mes të projektit “Kosova e re” dhe projektit “Kosova C”, që ju të na bindni me argumente se projekti i ofruar nga Qeveria është më përfitues dhe me interes nacional në krahasim me termocentralin “Kosova C”, sepse ajo çka ka ngjarë gjatë këtij procesi është se kompanitë prestigjioze janë tërhequr, do të thotë, kompanitë prestigjioze në fushën e prodhimit të energjisë nga linjiti janë tërhequr nga gara dhe kjo është shembull i një politike jo të mirë, çmimin e të cilit do ta paguajnë konsumatorët.

Strategjia, gjithashtu, nuk përmban sqarimet e duhura për projektin “Kosova e Re” dhe mungesa e qartësisë dhe transparencës kërkon përgjigje në disa pyetje, të cilat unë do t'i shtroj.

Zonja ministre,

Më lejoni që t'ju shtroj këto pyetje:

1. Sa është planifikuar eksporti i energjisë në treg?
2. Sa do të plotësohen kërkesat mjedisore?
3. A ka vlerësim të privatizimit, të avantazheve dhe disavantazheve të tij?
4. A ka vlerësim të taksave ndaj shtetit?

5. Dhe, ndoshta më e rëndësishmja – sa do të përfitojë Kosova financiarisht nga privatizimi i sektorit të vet të energjisë?

Në dokument thuhet se do të ndodhë gjithashtu shthurja e KEK-ut. Nëse është kështu, zonja ministre, çfarë do të ngjajë me punëtorët e KEK-ut?

Sa i përket çmimit të rrymës, nuk janë të qarta politikat dhe masat për rritjen e çmimit të energjisë dhe mundësitë e përballimit të konsumatorëve për kah rritjet e çmimit të energjisë.

Sa i përket sektorit të ngrohjes, thuhet se nevoja për zhvillimin e tregut të këtij sektori është evidente dhe se Qeveria planifikon, pra, që të bëjë zhvillimin e këtij tregu duke u mbështetur në masat nxitëse. Cilat janë ato masa, duke marrë parasysh se ne sidomos këtë vit kemi vuajtur nga të ftohtit, s’kemi pasur nxehje?

Meqenëse Kosova është edhe anëtare e Task-forcës për eficiencë të energjisë, ka përgjegjësi për krijimin e planit nacional për veprimet për eficiencën e energjisë për vitet 2009-2011. Ky plan nuk është hartuar, e ne jemi në vitin 2010. Sa do të kemi kursim të energjisë në qoftë se nuk kemi plan?

Të nderuar deputetë,

Për suksesin e strategjisë na duhet udhëheqje e ndershme dhe e pastër. Ne jemi larg nga dita e përparimit të sektorit energjetik dhe e ngritjes së cilësisë së jetës së qytetarëve, sepse na mungon lidhshipi që është i lirë nga korrupsioni real. Prandaj, Kuvendi i Kosovës duhet të jetë autoriteti përfundimtar për marrjen e vendimit për zhvillimin e kësaj strategjie dhe në veçanti për kushtet dhe kriteret e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike në Kosovë, në kuadër të projektit “Kosova e re”. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministra, deputetë të nderuar,

Rishikimi i strategjisë i përngjanë më shumë një raporti se një strategjie dhe i referohet periudhës trevjeçare të vitit 2009-2011, do të thotë se sot na ofrohet një strategji për atë miratim retrograd nga viti 2009 dhe do të thotë që kjo strategji është strategji e vjetruar.

Qeveria në një dokument të rëndësishëm si ky fare nuk paraqet dëmet dhe planet e Qeverisë për të dalë nga situata në raport me Serbinë. Serbia ka shkelur çdo marrëveshje nga viti 2004 për të paguar kompensimet për transit të energjisë elektrike si dhe inkason të hyrat nga transitimi i energjisë elektrike dhe i përvetëson ato në dëm të Kosovës në miliona euro, si dhe pasojë e mos shtrirjes së pushtetit në pjesën veriore kemi faturimin e energjisë së shpenzuar për konsumatorët të cilët furnizohen kryesisht me energji të prodhuar në Kosovë ku tani me dijen e Qeverisë, EULEX-it dhe UNMIK-ut që 3 muaj rresht kemi faturimin në emër të kompanisë nga Serbia, që pritet të ketë edhe pagesë nga qytetarët konsumatorë në veri. Dhe, kjo strategji fare nuk parasheh ndonjë plan të menaxhimit të aseteve të furnizimit për pjesën veriore.

Strategjia për shthurjen e KEK-ut dhe projekti i termocentralit “Kosova e re”, futja apo mos futja e termocentralit “B” në paketën tenderuese, fati i minierës së Sibovcit, megjithë

mungesën e transparencës si e tillë nuk është strategji për interesat e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Sipas strategjisë dhe konsulentëve të transaksionit ende nuk është e njohur vlera e aksioneve të Kosovës në këtë projekt, a do të jepet “Kosova B” në pronësi të investuesit si dhe a mund të përfshihet apo mos të përfshihet një pjesë e caktuar të , apo të rezervave të minierës së re. Sfidë kryesore e paketës tenderuese mbetet vënia e termocentralit “Kosova B” në pronësi të investuesit, meqë është e qartë se disponimi i valorizimit të termocentralit “Kosova B”, tani për tani mungon nga ana e konsulentëve për interesat e tyre personale e që mund të ketë projeksione shumë negative për vendin tonë.

Një nga arsyet e stërzgjatje së këtij projekti jetik për ekonominë e Kosovës dhe shkak i frustrimit të investitorëve si dhe subjekteve vendore është shumë qartë mungesa e një infrastrukture ligjore, si Ligji për kushtet e konsensionimit të potencialeve energjetike, duke përcaktuar kriteret e konsensionimit gjithmonë mbi bazat e interesit tonë shtetëror, si dhe mungesa e një studimi bindës për kost-benefitin duke pasur parasysh ndikimet negative në cilësinë e ambientit, cilësinë e shëndetit të popullatës. Andaj, Kosova duhet qartë të dalë me përfitim të mjaftueshëm nga ky projekt madhor.

Dhe, së fundi, teoria ekonomike në lidhje me resurset natyrore dhe demokracinë janë në mospërputhje. Shumë shpesh mendohet se a është mallkim apo bekim të pasurit e resurseve natyrore, ngase fatkeqësisht ato ngritin forcat regresive me qëllim të pasurimit nga resurset natyrore e kjo gjithsesi e ulë demokracinë në atë vend. Kështu mendojmë që strategjia për energji e Kosovës konsideroj që është e pafavorshme për shtetin e Kosovës dhe që duhet gjithsesi të hapet një debat më i gjerë publik, ngase nëse nuk bëjmë një strategji të mirë tani, në vend që të hapim do të mbyllim derën e zhvillimit të këtij sektori dhe do t’i dënojmë gjeneratat e reja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi!

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet, të nderuar ministra prezentë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht që ne të gjithë e kemi lexuar strategjinë, po jo të gjithë jemi profesionalisht të përgatitur të japim ndonjë kontribut të madh, mirëpo, meqë bëhet fjalë për një strategji që është pjesë e strategjisë së zhvillimit të vendit në një periudhë pasluftë, sigurisht që dimensionin politik i çdo strategjie është përafërsisht i njëjtë dhe ajo që duhet të përmbajë çdo strategji është përpjekja për menaxhimin sa më të mirë të resurseve natyrore që ka një vend për t’i vu ato në funksion të zhvillimit ekonomik. Dhe, strategjia që e kemi, që ka të bëjë për energjinë, mendoj se përmban dy dimensione njëkohësisht ose paralele – projektin “Kosova e re” dhe privatizimin e kapaciteteve ekzistuese.

Unë dua t’ju rikujtoj vetëm diçka që subjekti të cilin e përfaqësoj unë, ne na vjen mirë, që pjesë të programit tonë për energjetikën që janë publikuar në vitin 2007, në programin tonë zgjedhor janë pjesë e kësaj strategjie. Po na vjen keq në të njëjtën kohë që kopjimi ka qenë i dobët dhe nuk është e tërë ajo që ne e kemi paraparë.

Te privatizimi, ne kemi qenë kundër privatizimit, kështu së paku siç thuhet që do të jetë për të krijuar monopol tjetërkund dhe këtë e kemi pasur parasysh se Kosova është në një fazë të ndërtimit të shtetit, në një fazë të krizës ekonomike, në një fazë post-konfliktuale

dhe historia më e re e vendeve të Evropës Perëndimore, na mëson që pas krizave shteti ruan disa asete, përkatësisht ruan të drejtën e participimit në shfrytëzimin e aseteve nacionale qysh është industria e thëngjillit, industria energjetike e tjera. Këtë e ka bërë edhe Anglia, edhe Franca, e kanë bërë të gjitha shtetet që kanë ruajtur 20%, jo në kuptimin e ndërhyrjes, e kontrollit, por në kuptimin e subvencionimit, në kuptimin e planifikimit më të mirë, në kuptimin e facilitimit, ndihmesës për t'u zhvilluar ai resurs.

Dhe, këtë nuk e shohim tash. Ne kemi diçka, nuk mund të themi që aty nuk ka kurrëgjë dhe mund të privatizohet çdo kohë gjithçka, sepse po vihen në pikëpyetje kapacitet ekzistues që megjithatë prodhojnë sot dhe e bartin barrën e furnizimit, barrën kryesore qysh është “Kosova B”. Dhe tash nëse krejt futet në një pako ne kemi frikën se po e dëmtojmë, sepse qasja jonë ka qenë qasje e zgjidhjes suksesive të problemit të energjetikës në Kosovë. Duke rivitalizuar kapacitetet ekzistuese, duke investuar në kapacitete kufizuese në Kosovë, atëherë “Kosova C” tash “Kosova e re” dhe ne na vjen mirë që do të shkohet 500 plus 500, sepse është dalë se s’ka zgjidhje tjetër, por jemi shumë të përmbytur që ta mbështesim mënyrën e privatizimit dhe për këtë e mora fjalën. Po them jemi të kënaqur që një pjesë e strategjisë tonë është marrë, por që do të ishte mirë të merrej e tëra, sepse mendojmë që kemi pasur qasje më të avancuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në sallë janë 62 deputetë. Fjalën e ka Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Vërtet dokumenti i prezantuar i strategjisë me keqardhje them lë disa dilema, në aspektin e kapaciteteve është dilemë, që në fakt ende nuk është sqaruar deri në fund, në aspektin e pronësisë rreth kapaciteteve ekzistuese, po ashtu është dilemë dhe në aspektin e vendit të ndërtimit të kapaciteteve të reja, respektivisht projektit “Kosova e re”. Këto tri dilema edhe pse janë të theksuara edhe në strategji nuk duken shumë të konkretizuara, mua prapë më lë përshtypjen se strategjia hap rrugën e krijimit të një infrastrukture të përshtatshme për transformimin dhjetëvjeçar të energjetikës kosovare. Edhe pse respektoj mendimin edhe të deputetëve tjerë dhe orientimet e tyre, por më befasojnë disa diskutime, sidomos të përfaqësuesve të grupacioneve politike që e mbajnë veten si të djathtë, me orientime të qarta programore dhe këtu vërehen elemente të partive të gjelbra, vërehen elemente të partive neo-majtiste, edhe në kuptimin e transformimit të pronës edhe në kuptimin e bërjes së biznesit, në përgjithësi kur është fjala edhe për energjetikën në veçanti.

Sfida qëndron në nivelin e kapaciteteve. Në qoftë se vërtet ne aspirojmë të jemi në tregun regional të zhvillimit të energjetikës dhe e kemi në ndër dije mos të humbim kohën që e kemi humbur deri tani në ndërtimin e kapaciteteve energjetike, minimumi i shkuarjes për këtë dhjetëvjeçar është 1.000 megavat, minimumi! Dhe, ky mund të shkojë deri në 2.000 megavat, kjo do të ishte qëndrimi im personal edhe pse në parim nuk jam shumë në kundërshtim me qëndrimin edhe të Grupit Parlamentar.

Sfida qëndron edhe te privatizimi. Në fakt në qoftë se dëshirojmë Kosovën të jetë pjesë edhe në tregun regional edhe në tregun evropian, që ne krenohemi me sektorin energjetik, që jemi faktor në këtë treg, atëherë padyshim me këto kapacitete ekzistuese, me këtë menaxhim ekzistues të kapaciteteve energjetike në Kosovë, nuk mund të jemi konkurrent në tregun regional, sepse ka mangësi të mëdha edhe në menaxhim, ka mangësi të mëdha edhe gati në të gjitha fushat, edhe interferimet e ndryshme dhe së

fundi, çka është shumë e rëndësishme, burim i korrupsionit në Kosovë, burim i nepotizmit në Kosovë, janë mu këto ndërmarrjet publike, andaj aq sa është e mundur në afat jo të gjatë, por në afat të shkurtër të lirohemi prej këtyre dinozaurëve publikë apo shtetërorë, që në fakt këtu më befason qëndrimi i disa kolegëve të mi kur mendojnë se interesi nacional i Kosovës qenka në mbajtjen e pronësisë publike apo shtetërore. Jo, interesi nacional i Kosovës është zhvillimi ekonomik dhe konkurrimi ynë në tregun regional apo evropian, jo vetëm në energjetikë, po edhe në fusha tjera, e atë konkurrim do ta bëjmë vetëm me një energjetikë të transformuar edhe në aspektin pronësor, por edhe në aspektin sektorial, domethënë jo vetëm përmes TC-eve, por edhe përmes formave tjera aero-energjetike apo formave të hidros.

Sfida qëndron edhe në bazën e thëngjillit të Sibovcit, që padyshim nuk duhet dhe nuk i jap vetes atë komoditet që të them tash, meqenëse nuk kam shënime të sakta në lidhje edhe me transformimin edhe mënyrën e shfrytëzimit të Sibovcit - të basenit të thëngjillit, që në fakt krijon bazë të mirë për investitorët.

Esenca e kësaj strategjie që më jap atë motivin për ta përkrahur qëndron në thithjen apo inkurajimin e investitorëve potencialë në sektorin e energjetikës. Andaj, duke u nisur nga kjo premisë, unë mendoj se strategjia ka bazë të mjaftueshme për të ecur përpara në periudhën dhjetëvjeçare. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Meqë në masë të madhe nuk është zbatuar strategjia e energjisë për periudhën 2005-2015 e posaçërisht nuk është vazhduar me programin e filluar më parë për zbatimin e strategjisë afatshkurtër të energjisë 2005-2008, si në raport me kohën, ashtu edhe në raport me hapat e reformave që duhet të ndërmerren për implementim, fitohet përshtypja se kjo strategji apo ky dokument i prezantuar sot po fillon prej sot dhe atëherë shtrohet pyetja se me çfarë strategjie është udhëhequr Kosova në këto vitet e fundi?

Ligji na obligon që strategjia afatgjate të revidohet çdo 3 vjet. Jeni dëshmitarë që kemi pasur një qasje të ashtuquajtur të një strategjie ditore apo mujore apo për konsum, varësisht prej nevojave të Qeverisë.

Ky dokument që na është shpërndarë tani është i vjetëruar, sepse në ndërkohë ka pasur zhvillime dhe implementime të politikave të rishikuara në baza mujore dhe se proceset janë udhëhequr nga parimet e një strategjie në ecje. Meqë tani jemi në vitin 2010, shtrohet pyetja, nëse nuk është vazhduar me hapa të programit për zbatimin e strategjisë afatshkurtër 2005-2008 e gjithashtu nuk është bërë rishikimi i strategjisë afatshkurtër për periudhën trevjeçare 2008-2011, me çfarë objektivash strategjike është udhëhequr sektori i energjisë në Kosovë? Kjo është një pyetje që do ia bëja ministres dhe Qeverisë.

Çka ka ndodhur në periudhën e këtyre dy vjetëve të fundit 2008-2010? Kjo periudhë nuk është mbuluar me asnjë dokument strategjik, as i politikave reformuese. Që kanë stagnuar proceset e filluara, këtë e dimë të gjithë, po a jemi të sigurt që e dhe ky dokument që na është prezantuar sot do të zbatohet. Është mirë që dokumenti të emërohet si strategjia 2010-2011 për shkak se na ka ardhur sot.

Sa i përket projektit “Kosova e re” kapacitetet e reja duhet të mundësojnë plotësimin e energjisë që na mungon dhe kërkesës në rritje që në vit është 8%. Energjinë që do ta humbim kur të mbyllet “Kosova A” dhe energjinë që nevojitet për shkëmbim, një bllok prej 500 megavat orë nuk na mundëson plotësimin e këtyre nevojave shtesë për energji. Po e ritheksoj, do të thotë gjithë këto zvarritje që kanë ndodhur, gjithë kjo vonesë që ka ndodhur dhe në fund nuk do të kemi energji as për konsum të brendshëm.

Gjithashtu në vitin 2015 dhe 2016, kur pritet të fillojë prodhimin “Kosova e re” nëse vazhdon, do të thotë, projekti në fjalë, planifikohet, po ato vite të kryhen revitalizimet e “Kosovës B” përmbushjen e kërkesave dhe mbylljen, do të thotë e “Kosovës A” për shkak të kërkesave mjedisore. Atëherë, shtrohet pyetja se sa do të kemi energji në vitin 2015 dhe 2016? Do të thotë 2015 dhe 2016 do të jenë vite kritike për furnizim me energji elektrike.

Në dokument, në faqen 41, ku analizohen parashikimet e kërkesës për energji, shkruan “Kërkesa në vitin 2018 parashihet të arrijë 1.543 megavat orë, sipas skenarit të mesëm”. Me këtë trend të zhvillimit të kapaciteteve të reja energjetike, duke marrë parasysh edhe mbylljen e “Kosovës A”, a do të jemi në gjendje për t’i plotësuar kërkesat për energji sipas këtij dokumenti në vitin 2018 në bazë të skenarit të mesëm - kemi faqen 41, e le më në skenarin e lartë të kërkesës për energji?

Me siguri që nuk keni për ta arritur këtë, për shkak të vonesave të pajustificueshme që kemi pas deri tani.

Ky dokument, në fakt si i tillë e jep vetëm një zgjidhje për problemin me furnizimin me energji elektrike dhe atë në faqen 43, për një periudhë të ardhshme deri në aktivizimin e termocentralit “Kosova e re” mbulimi i bilancit të energjisë elektrike do të arrihet nëpërmjet importit. Unë e kam një pyetje kush e mban përgjegjësinë për të gjitha këto vonesa dhe për miliona euro që duhet të jepen nga buxheti i Kosovës, në vend që me to të sanohen, do të thotë problemet e shumta, për shembull në shëndetësi, në arsimim, në zhvillim ekonomik, në investime, subvencione në bujqësi, me miliona euro duhet të japim për energjetikë për të blerë, për të importuar energji elektrike me çmime astronomike, për shkak se jemi vonuar dhe po vazhdojmë të vonohemi, prandaj përgjegjësi duhet të japë Qeveria e Kosovës, me që nuk ka strategji të mirëfilltë, janë menaxhuar vetëm krizat dhe është përmirësuar furnizimi me energji elektrike, mirëpo e kemi rritur importin, në vazhdimësi dhe kemi shpenzuar miliona euro.

Në faqen 48....

KRYETARI: Faleminderit!

Drejtimitin e seancës e merr Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti dhe kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

Në të vërtetë, çështja e strategjisë që po e debatojmë sot, është e një rëndësie të veçantë, po më lejoni t'i them pak fjalë edhe unë për këtë dokument të rëndësishëm. Mendoj që deputetët e kemi përgjegjësi ta kemi një kontinuitet se dikush është që dy e tri mandate. Kur ne kërkonim që Qeveria e kaluar ta hartonte strategjinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, kur ne kërkonim në mandatin e kaluar të hartohet strategjia e interesit nacional, deputetët që sot janë tepër të zëshëm, atëherë çdo veprim të Qeverisë, edhe atëherë kur vërtet s'kishte asnjë bazë ligjore dhe asnjë strategji të veprimit, mbështetëj. Tani kemi kërkesa, thuaja se vetëm këto dy vjetët e fundit ne jemi në këtë gjendje që jemi. Unë e di që në këtë fushë në Kosovë ka ekspertë dhe unë e di që disa nga ekspertët, për të cilët është menduar edhe sot në sallë, kanë qenë në drejtim të KEK-ut, si shef ekzekutiv i KEK-ut në tërësi dhe gjithashtu e dimë që ata ekspertë janë bërë të dëgjueshëm nga këshilltarët e tjerë që unë mendoj që gjatë këtyre dhjetë vjetëve e kanë rrënuar dhe e kanë dëmtuar shumë sistemin e energjetikës në Kosovë dhe qëllimi ka qenë për ta zvogëluar vlerën e saj dhe ajo vlerë është zvogëluar. Ne e dimë që e kemi mbështetur privatizimin të gjithë, se të gjithë këtu, me ndonjë përjashtim të vogël, si subjekte politike e kemi kërkuar qeverisjen e këtij vendi dhe e dimë që privatizimi që është bërë në Kosovë, s'ka pasur asnjë mekanizëm tjetër, as instrument tjetër që e përcjell se vërtet a po bëhet privatizimi mbi bazën e kontratave që janë arritur dhe kjo nuk është diçka e re. Ne e dimë që edhe kjo strategji nuk është më e mira e mundshme, është një përpjekje për të bërë ndryshim në sistemin e energjetikës në Kosovë dhe mendoj në këtë rrafsh duhet ta përsërisim, por duhet, vërtet unë pajtohem me diskutimin, sidomos të Berim Ramosajt. Jo, në pikëpamjet dhe bindjet e mia personale ndoshta edhe unë mendoj ndryshe. Por, vërtet, unë mendoj që Komisioni përgjegjës në Parlamentin e Kosovës, me përgjegjësit e grupeve parlamentare, që asnjë grup parlamentar nuk e ka një strategji të vet të qartë se çka do të bëhet me asnjë segment të jetës në Kosovës. Këtu dalim e flasim vetëm për opinionin, sa për të thënë që di. Mendoj që duhet të bëhet një përgatitje mbi baza të ekspertëve, por edhe mbi bazën e mundësive që kemi. Ne mund të themi se nuk do ta privatizojmë "B"-në, as "B1" as "B2", edhe pse gjatë këtyre dhjetë vjetëve ka pasur mundësi të ndërtohet "B3" që e ka pasur bazamentin dhe asnjë ekspert gjatë gjithë këtyre viteve s'e ka marrë mundimin të thotë – po ngadalë se na duhet një investim jo i madh për të ndërtuar një "B3", që mund t'i ketë 200 deri 300 megavat energji elektrike. Dhe, këtu bile nuk e përmendi askush që është bazamenti, ka qenë një bazë e mirë e ndërtuar dhe përgatitur për "B3". Prandaj, ne duhet të pyesim, jo çka duam ne, po çka mund të bëjnë investitorët – a duam t'i tërheqim investitorët, a duam t'i largojmë ata? Dhe, të këtë përgjegjësi dhe përgjigjen për këtë përgjigje duhet ta japë Qeveria, natyrisht, mbi bazën e propozimeve të ekspertëve. Qeveria ka mundësi të bisedojë me investitorët. Ne si Parlament s'kemi mundësi. Kjo është e ditur. Do të thotë, s'kemi mundësi, por ne duhet të kërkojmë me Qeverinë, cilat kanë qenë rezultatet e bisedimeve me investitorët dhe cila është fusha e interesit të tyre se asnjë investitor nuk vjen në Kosovë për hatër tonin, as pse na donë neve shumë, por investitorët vijnë për të nxjerrë profitin e tyre, interesin e tyre. Natyrisht, ne duhet ta dimë edhe interesin tonë, por megjithatë ne duhet të bashkojmë interesin tonë me interesin e investitorëve, por ne si Kuvend, unë mendoj, sot kryesisht kemi debatuar cili është interesi jonë. Ne të gjithë e dimë cili është interesi ynë, por këtu është edhe pala tjetër që duhet, i ka interesat e veta dhe i ka kërkesat e veta. Ne si Parlament, edhe një herë po them, nuk mund t'i harmonizojmë këto. Ne çka mund të bëjmë, ne duhet të kërkojmë nga Qeveria që e kemi zgjedhur vetë, ose e kemi zgjedhur shumica, ne kemi bërë koalicion për ta zgjedhur një qeveri.

Cilat janë mundësitë tona reale? Dhe, a mund ta ruajmë pa e privatizuar "B"-në? Nëse nuk mundemi, atëherë duhet të hyjmë në bisedime, gjithnjë Qeveria, që të krijojë një

ambient të përshtatshëm, një interes për qytetarët e Kosovës dhe për të dalë nga kriza energjetike. Linjiti mund të flejë, si bazë edhe në gjithë Kosovën. Ne mund të vazhdojmë të jemi në terr, prandaj e vetmja mënyrë për të pasur dritë, ne duhet ta shfrytëzojmë linjitin, burimin kryesor të energjisë në Kosovë. Por, edhe këtë, gjithnjë po them, duhet të kërkojmë nga Qeveria, nga ekspertët tanë, po i thërrasim edhe ekspertët tanë për të biseduar dhe për të përfunduar një strategji të pranueshme dhe, natyrisht, në këto bisedime s'mund t'i lëmë as njerëzit që janë të interesuar, as këshilltarët e transaksioneve ose të këshilltarët e investitorëve të interesuar për të investuar në këtë fushë dhe duhet të gjejmë një interes të përbashkët që të dalim, por bash si duam ne, nuk mundemi dhe vërtet këtë duhet ta trajtojmë si një interes nacional dhe një interes të përbashkët nacional. Kosova nuk është as më pak e një partie, qoftë në opozitë, qoftë në pozitë, është një interes i të gjithë neve, dikush jemi sot në pozitë, nesër mund të jemi në opozitë dhe kështu, do të thotë, ndryshohet bota, siç thotë edhe Mjeda: “ bylbyl, ky shekull orë e qas ndërron”. Pra, duhet të mësohemi ta presim edhe ndërrimin, jo t'i japim zor para kohe.

Do të thotë, unë jam që debatin ta përfundojmë, ta zhvillojmë një debat me ekspertët e jashtëm dhe vendorë, që duhet të udhëhiqet nga komisioni përkatës, natyrisht, me prezencën e Qeverisë dhe këtë strategji që e kemi mendoj duhet ta miratojmë dhe duhet të ecim para, ndoshta nga pak edhe me dhembje, se çdo lindje është me dhembje. Këtë, mendoj, duhet ta kuptojmë të gjithë. Unë ju falënderoj për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Do të mundohem të jem shumë i shkurtër. Unë mendoj që një pjesë e deputetëve që diskutuan parimisht e pranuan që strategjia në sektorin e energjisë është diçka e domosdoshme dhe shumë e nevojshme, duke marrë parasysh se gjendjen aktuale të cilën e kemi për vite të tëra, kur buxheti i Kosovës duhet ta mbështet këtë kompani publike për të siguruar drita, kur humbjet në sektorin e energjisë janë diku 25% nga prodhimi i përgjithshëm, ku importi nga viti 2002, nëse më kujtohet, në vitin 2000, ka qenë 33% kurse sot ndoshta ka ra deri në 13 apo 14% , por statistikën e fundit nuk i kemi shumë ndoshta të qarta dhe nuk janë shkruar as në strategji, kërkon domosdoshmëri që ta kemi këtë strategji për të ndryshuar edhe formën e menaxhimit, për të ndryshuar edhe situatën që e kemi, prandaj ndoshta parimisht të gjithë u pajtuam se janë tri parime të cilat duhet për t'u mbështetur këtu, gjithsesi.

Natyrisht që në bazë të propozimit që ka ardhur, në bazë të strategjisë që po e shohim, pritet që të ketë një zhvillim ekonomik dhe kjo duhet të jetë e pranueshme për të gjithë ne. Parashihet edhe një reformë në të gjitha termocentralet që ekzistojnë dhe natyrisht kjo do të ndikojë pozitivisht që të mos kemi këtë ndotje të ambientit. Ju e dini, shumë raporte të cilat kanë ardhur negative dhe e dini edhe shëndetin që e kemi mjaft diskutabil për shkak të ndotjeve që bëhen dhe askush nuk merret fare me çështjen e pastrimit nëpër këto termo-elektrana ekzistuese.

Dhe, çështja tjetër, nga projekti dhe strategjia, të gjithë po supozojmë se do të kemi një përfitim edhe të kategorisë sociale, do të kemi një situatë pak edhe më të mirë. Mirëpo,

çështja pse unë mendova që të diskutoj, është se ne kemi edhe një dokument para veti. E kemi rekomandimin e Komisionit funksional dhe tani me plot të drejtë deputeti Berim i ngriti tri dilema, kurse unë e kam vetëm një dilemë. A t'i përkrahim rekomandimet e Komisionit? Gjithsesi, nëse i shohim rekomandimet janë së paku për mua si deputet të pranueshme. Por, në pikën b) Komisioni ka rekomanduar, thotë "Termocentrali "Kosova e re" mundësisht, është kjo në pikën a) në të vërtetë, është rekomandimi që "Kosova B" të mos përfshihet në pakon e tenderimit. Për këtë personalisht si deputet edhe do të votoj edhe do ta pranoj rekomandimin. Por, në çështjen tjetër, është një dilemë. Komisioni ka kërkuar të mbetet pronësi e shtetit. Tash është çështja diskutuese, për sa kohë e ka menduar, a jemi në koncept të drejtë që të mbetet pronë e shtetit, sepse ne aktualisht e kemi pronë publike dhe e dimë situatën ku jemi, kemi situata që njerëzit rrinë edhe me nga 10 a 15 ditë pa rrymë elektrike dhe shumica e tyre pa fajn e tyre, sepse një pjesë paguajnë energjinë elektrike, andaj këtu ndoshta do të duhej dhënë një sugjerim edhe Komisioni, për ta harmonizuar me ministrinë përkatëse si e ka menduar të jetë në pronësi të shtetit dhe për sa kohë apo ka menduar që fare ky termocentral, asnjëherë të mos privatizohet. Ndoshta është çështje shumë e rëndësishme, sepse këtu s'e kemi rekomandimin e qartë.

Dhe, krejt në fund, unë mendoj se në fund të takimit pas debati duhet të nxjerrim disa konkluzione, sepse ne nuk kemi mundësi në njërën anë ta votojmë strategjinë dhe në anën tjetër rekomandimet e Komisionit, por është mirë të përqendrohemi në disa rekomandime që do të dalin e mandej Kuvendi të përcaktohet që ato të futen në strategjinë që ka ardhur nga Qeveria e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet deputeti Ibrahim Selmanaj.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndes kryetarin, ministrat dhe të gjithë parlamentarët,

KEK-u është një sektor, i cili ka rëndësi të jashtëzakonshme për jetën moderne. Ai është i rëndësishëm, prej ekonomisë familjare, deri te ekonomia shtetërore, madje një krahasim i tepruar, ndoshta, siç është dielli i rëndësishëm për ditën, ashtu është KEK-u është i rëndësishëm për ditën dhe për natën në jetën tonë moderne, por kjo është tashti pak e ekzagjeruar, por deri diku e vërtetë.

Një problem edhe KEK-u e ka në mos pagesën e rrymës, të një përqindjeje shumë të madhe të konsumatorëve të rrymës. Madje, është edhe një problem tjetër, se jo vetëm se nuk e paguajnë konsumatorët disa, një pjesë e madhe, por edhe po e vjedhin rrymën. Domethënë, është një element aty i jashtëzakonshëm i cili duhet të zgjidhet në njëfarë mënyre. Dikur kanë qenë përmendur këtu mënyra e pagesës të bëhej me kartela, si e kemi në telefoninë mobile. Vetëm është përmendur kjo punë dhe nuk dihet a është marrë më kush me këtë problem, por kjo do të ishte mënyra më e mirë dhe më e lehtë, tash nuk po di si shkon teknikisht, por më e mirë dhe më e sigurt për t'i pasur KEK-u ato kompensimet që duhet t'i ketë. Prandaj, ndoshta ishte dashur të merret kjo punë shumë serioze dhe të bëhet diçka në këtë drejtim. Përveç kësaj, mendoj që dikur ka qenë planifikuar që Ngrohtorja e Qytetit të lidhet me termocentralet që i kemi në Obiliq. Kanë qenë bile edhe gypat nëpër fusha, e ndoshta mund të jenë edhe sot aty-këtu, por është heq dorë nga ky projekt. Ndoshta do të jetë, në qoftë se nuk është tepër i rëndë për buxhetin e Kosovës, do të jetë një zgjidhje shumë e mirë e dyfishtë, edhe rryma, edhe Ngrohtorja e

Qytetit do të siguroheshin shumë më në rregull dhe shumë më lirë, do të ishte edhe KEK-u aty një përfitues i kësaj mundësie.

Këtu u fol edhe për ndotjen e ajrit dhe u tha se nuk është gjithaq ai problem, por madje tymi i këtyre termocentraleve qenka edhe një, si të themi, element që mund të shitet në botën perëndimore, e që do të përpunohet atje e tjera. Ne nuk e kemi atë mundësi që ta përpunojmë, se nuk kemi mundësi t'i përpunojmë as mbeturinat të cilat na rrethojnë nga të gjitha anët.

Do të ishte mirë që edhe në këtë drejtim të merren disa masa që ta sheshim, megjithëse qenka çmimi i lirë, e thanë këtu, që po na ofrohet, por meqenëse ky tym po shkaktonte më shumë kancer se sa rrymë, atëherë ndoshta këtë tym kemi hesap edhe t'ia falim Perëndimit, po le ta marrin me vete bashkë me kancerin që na është lënë këtu.

Përveç kësaj, më duket se privatizimi i çdo gjëje është një rrugë jo e mirë për shtetin. Shteti duhet të ketë, sipas mendimit tim, në çdo sektor bile 51% në duar të veta, duhet ta përfaqësojmë shtetin e jo sektorin privat, i cili do të shikojë vetëm interesin e vet. Prandaj, këto janë disa probleme që më ranë ndërmend dhe i parashtrova këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Mark Krasniqi. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Selmanaj dhe i fundit Zef Morina.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra prezentë, dhe ju kolegë deputetë,

Po mendoj se është konsumuar debati dhe nuk do të lëshohem në detaje të diskutimeve të cilat janë bërë prej deputetëve që kanë diskutuar deri tash. Do t'i them ministres, po në të njëjtën kohë edhe kryetarit se këta deputetë të cilët janë prezentë këtu po edhe tjerët që nuk janë këtu e shohin si një temë shumë të rëndësishme energjetikën dhe fushën e energjetikës. Ne po jetojmë me terrin bashkë dhe këto dhjetë vjet pas lufte, faji është i të gjithëve, faji është i secilit që nga pak ka trashëguar, po nuk mundemi t'ia lënë krejt njëri-tjetrit.

Unë do të përmend tri pika për të cilat mendoj se duhet të kemi përgjigje.

E para është, çfarë veprimi do të bëjmë me enklavat dhe borxhin që është në vlerë prej 100 milionë eurove, ndërsa ne diskutojmë një strategji për dhjetë vjet më tutje. Domethënë, 100 milionë borxh janë nga minoritetet të cilët jetojnë në Kosovë, përfshirë këtu edhe veriun e Kosovës.

Problemi i dytë që është sot aktual janë shkyçjet kolektive dhe mbi këtë bazë me qindra dhe mijëra familje sot janë pa rrymë dhe ka edhe më shumë se tri javë, kjo ndodh në gjithë territorin e Kosovës, po më duhet përmend faktin se vetëm një fshat i komunës së Deçanit që ka 6000 banorë, Isniqi që tri javë nuk ka rrymë, e njëjta situatë është në Pejë.

Problemi i tretë, Konventa ndërkombëtare, që Qeveria e Kosovës e ka nënshkruar në vitin 2007 dhe jemi obligativ që t'i respektojmë marrëveshjet si anëtarë të barabartë në fushën e energjetikës për gjithë Evropën Juglindore. Në këtë radhë, kategoritë sociale janë të garantuara nga Qeveria e Kosovës që të paguajnë përafërsisht 500 kilovatë energji elektrike, ato familje që janë në kategori sociale.

Dhe, problemi i fundit që lidhet në këtë rast, në këtë mes. Në shkycjet kolektive të cilat ndodhin tash, ku përfshihen edhe kategoritë sociale, po edhe shumë familje të cilat kanë paguar, nëse këto familje do të ushtrojnë kallëzim penal ndaj KEK-ut dhe do të fitojnë kompensim prej KEK-ut, cila do të jetë strategjia që e përdor tash Qeveria e Kosovës – Ministria e Energjetikës? Bëhet fjalë për familjet tona, për rastet sociale, për kategoritë edhe që kanë paguar, po edhe që nuk kanë paguar. Dhe, mendoj se duhet të kemi një plan të qartë mbi këtë bazë – çka duhet vepruar, thjesht kemi interes që ta kemi një plan strategjik, plan që vërtetë do ta kisha mbështetur sikur të isha i bindur së pari nga këto tri fusha, të cilat ne i prekim, i shohim dhe nuk mund t'u ikim. S'e kisha në plan ta diskutoj, po deri tash kemi me dhjetëra mesazhe kur diskutohet për energjetikën dhe bëhet e njëjta pyetje prej qytetarëve që nuk kanë rrymë, a thua po mendon dikush sot për neve? Dhe, këto janë dilemat e mia, përndryshe si strategji është mirë që është hapur si debat më shumë. Dhe, këtu edhe ka politikë dhe ka përfaqësime politike dhe interesa të grupimeve politike, por përfundimisht është diskutuar se si të gjejmë një formë që ta kemi një stabilitet në fushën e energjetikës. Dhe si strategji dhe si formë e prezantuar para Kuvendit, singërisht po them nuk ia vlen për t'u marrë me dokumentin dhe unë nuk do ta votoj, mirëpo kush e mendon se duhet ta kemi vërtetë stabil një dokument, atëherë nuk duhet për ta votuar këtë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Mendoj që strategjia të cilën Qeveria e ka prezantuar, edhe pse ka hapësirë për të diskutuar dhe për ta begatuar është mjaft qartë e prezantuar dhe mendoj që duhet të përkrahet nga ne deputetët. Energjia elektrike është faktori kryesor i zhvillimit të një vendi. Kosova e cila është ndër shtetet e veçanta që ka pasuri nëntokësore ose natyrore siç është thëngjilli ose linjiti, e cila ka një kapacitet rreth 17 miliardë, e një kolege e tha më herët 13, por jo, mbi rreth 17 miliardë ton thëngjill, është shumë e vërtetë që ne duhet të mendojmë për një zhvillim shumë më të madh edhe për kapacitete të reja për eksploatimin e kësaj pasurie natyrore, për të krijuar energji elektrike. Natyrisht që kjo ka ndikim shumë të madh edhe në mjedisin, por duke pasur parasysh që teknologjia e kohës së sotme është aq e avancuar sa që sigurisht nuk do të ketë ndotje të ambientit, ndoshta sikur të ishin të ndërtuara hidrocentrale apo edhe këto të cilat janë me ndikimin e erës apo tjerat.

Me vëmendje dëgjuam ekspozenë e ministres, e cila elaboroi shumë qartë dhe shumë mirë atë çka Qeveria, gjegjësisht Ministria dhe komiteti drejtues e kanë në strategji dhe kërkesën apo si të them këshillat të cilët janë nga këshilltarët e transaksioneve.

Këtu shihet një ndryshim, domethënë, Qeveria mendon që kapacitetet duhet të jenë 1.000 megavat, ndërsa këshilltarët e transaksioneve japin 500 me kusht të zgjerimit plus 500. Sigurisht që këta e kanë parasysh, ne mendojmë ose do të pajtohemi më në fund që “Kosovën B” ta fusim në pako gjatë kësaj marrëveshjeje. Unë mendoj se “Kosova B” do të insistohet me çdo kusht të lihet anash, bile së paku për një afat kohor të caktuar dhe të diskutohet për “Kosovën e re”, me kriteret të cilat natyrisht ne si komision e kemi dhënë mendimin tonë, por unë pajtohem edhe me profesor Sabri Hamitin, i cili tha që duhet patjetër të kyçen ekspertët të cilët janë të mishëruar në këtë lëmi dhe ata do të na

ndihmojnë shumë që ne të jemi vërtet... oferta jonë ose kërkesa jonë të jetë maksimalisht e realizueshme. Është shumë normale se nuk ka asnjë investitor i cili vjen për të investuar, jo në Kosovë, por në asnjë vend të botës me humbje. Ai shikon interesin e vet, ne duhet të shikojmë interesin tonë dhe në këtë mënyrë duke i balancuar këto, mund të arrijmë të një zgjidhje e cila kishte me qenë shumë më e përshtatshme për ne.

Si do që të jetë, strategjia mendoj se është mjaft me vend dhe , në parim duhet të mbështetet, por është siç e ceku edhe kryetari Krasniqi, që ekspertët, bashkë me Komisionin të punojnë më tutje dhe ta kristalizojnë më mirë ose të japin kriteret e përcaktuara të cilat janë në interes të Kosovës.

Unë mendoj se ne si deputetë edhe pse disa ndoshta e kanë analizuar pak më me shpejtësi, duhet ta mbështesim këtë strategji, me kusht që natyrisht, bashkërisht t'i japim si me thënë kriteret ose një zgjidhje e cila kishte me qenë vërtet në interes të qytetarëve dhe qyteteve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ky ishte diskutuesi i fundit. Unë po e jap një propozim edhe një herë që Komisioni parlamentar, me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe me Qeverinë, mbi bazën e këtij debati të sotëm ta plotësojnë strategjinë, të bëjnë ndonjë rekomandim dhe në seancën e radhës, që mund të jetë sot një javë, ta votojmë.

A jeni dakord? Faleminderit!

Atëherë, e mbylлим këtë seancë dhe mirë u pafshim në seancën e radhës.

Përgatiti: Njësia e Transkripteve